



E mërkure
4 tetor 2017

Viti XVII
nr 160

Çmimi
30 L / 1 euro

E pavarur,
periodike

www.shqiperia-etnike.com
shqiperia_etnike@yahoo.com

English, page 13-14

Drejtor
Sokol Pepushaj



Në fund, ju nuk vlerësoheni se sa shumë keni ndërmarrë, por çfarë arrini në fund!

TRUMP



RAMA DHE BASHA DO TË QEVERISIN
Mustafa Nano
faqe 7



RAMA PO BËN MASAKËR URBANE...
Fatos Lubonja
faqe 3



VOTAT U BLENË ME PARA DROGE...
Ermira Therqaj
faqe 2

Pse Rama nuk mund të jetë autokrat, pavarësisht se ka pushtetin i vetëm?

Nga Spartak Ngjela



Sot po rishkruhet historia e Shqipërisë. Është historia e Arbërisë mijëvjeçare


Nuk e ndalon dot askush sot rigjallërimin e jetës së përbashkët të shqiptarëve në Ballkan. Historia do të rishkruhet. Vetë shteti shqiptar duhet të reformohet demokrarikisht bashkë me rishkrimin e historisë së shqiptarëve: ky është një kusht i garantuar historik që nuk mund ta shkelë apo ta smbrapsë dot askush

Reformimi i shtetit shqiptar aktualisht është marrë në dorë nga Uashingtoni dhe Brukseli. Dhe kjo është ngjarja historike më e madhe për shqiptarët në 500 vjetët e fundit.

Por, na duhet të theksojmë që është Uashingtoni dhe Berlini që e kanë bindur politikën perëndimore dhe vetë Brukselin drejt së vërtetës historike për... / faqe 7

Prek Cali Patriot apo tradhtar?!

faqe 8



Banda kriminale sulmon katër qytetarë në mes të Tiranës

Pardje, rreth orës 13:00 në rrugën "Ymer Ndregjoni" në Tiranë, dy persona me motor dhe skafandra në kokë, kanë dhunuar fizikisht Anëtarin e Këshillit Bashkiak të Fushë Arrësit dhe njëkohësisht i zgjedhur edhe si Anëtar në Këshillit e Qarkut Shkodër Selvator Gjoka. Ai ishte me makinë dhe po udhëtonte nga aeroporti "Nënë Tereza" së bashku me bashkëshorten Brunilda Doda, ... / vijon në faqen 2

Rënia tragjike e zgjedhjeve prej blerjes masive të votës

- Opinion -
Nga Preç Zogaj



Blerja masive e votës në zgjedhjet e ditës së diel nga PS, LSI dhe nga disa kandidatë të veçantë të partive me të vogla është e paprecedentë në historinë e demokracisë shqiptare. Në pikëpamje të efektit që ka pasur në rezultatin e zgjedhjeve shitblerja kapilare në fjalë i përqaset efektit që ka pasur rrethimi i zgjedhjeve me policë dhe shikas në vitin 1996... / faqe 6

Maskat sulmojnë vajzën e mitur të policit

Dje rreth ores 13:00, në Perash të Shkodrës, afër shkollës 9-vjeçare "Martin Camaj, tre persona me maska kanë zbritur nga makina e tyre dhe kanë sulmuar një fëmijë të klasës së 8-të të kësaj shkolle, duke u përpjekur ta rrëmbejnë... /f.3

Votat u blenë me para droge, parlamenti u mbush me kriminelë

Nga Ermira Therqaj

Qeveria u krijua, por vëmendja e opinionit publik dhe ndërkombëtarëve është tek dhunimi i votes së lire. Raporti përfundimtar i OSBE/ODHIR mbi zgjedhjet e 25 qershorit në Shqipëri, është skandaloz. me kritika të ashpra.

Në raport evidentohet edhe njëherë problemi me shit-blejen e votave në vendin tonë.

Sipas OSBE-së, shit-bleja e votës është problemi më i madh i këtyre zgjedhjeve, ndërsa kërkojnë që ky fenomen të rregullohet përmes mekanizmave ligjorë.

Në raport thuhet se “ditën e zgjedhjeve janë vërejtur parregullsi e mosveprime procedurale”. “Janë vërejtur votime në grup dhe ndërhyrje nga aktivistë partiakë”. Të ndryshojë ligji për grupet e numërimit, nuk duhet të jenë politike.

Një rekomandimet kryesore të OSBE është edhe hartimi i një reforme të re zgjedhore gjithëpërfshirëse. “Të thellohet depolitizimi i administratës publike”, thuhet gjithashtu në raportin e OSBE.

Të gjithë shqiptarët e dine se Saimir Tahiri, aso kohe Minister i Drejtësisë, përdori paratë e drogës për të blerë votën.

Po kështu, kryebashkiaku i Durrësit Vangjel Dako apo ai i Elbasanit Qazim Sejdiu, të akuzuar shumë here për lidhje me grupet kriminale të drogës dhe

trafikut të armëve e qenieve njerëzore, ishin aktive në blerjen e votës e tjetërsimin e rezultatit zgjedhior.

Për dy deputetët e Partisë Socialiste në qarkun e Lezhës Arben Ndoka dhe Arben Çuko, janë shprehur edhe ambasadorët Donald Lu e Romana Vllahutin, duke i akuzuar direkt si persona me problem, por Edi Rama organizoi strukturat e shtetit të dhunoje votuesit. Ai bleu votat në shtesat e varfëra të shoqërisë dhe ushtroi presione në qendrat e votimit, ku në Lezhë ka patur edhe të shtena me armë zjarri, duke plagosur një nga aktivistët e LSI-së në

Shëngjin, Florian Dushkun, plagosje që detyroi Presidentin e Republikës Ilir Meta të vizitoje vendngjarjen, i cili arriti deri në deklarata ekstreme dhe të frikshme:

“Mund ti bëjmë thirrje popullit të marrë armët kundër kriminelëve të Edi Ramës në mbrojtje të votës së lirë të popullit të dhunuar”

Kur shprehje të tilla i artikulon numri një i shtetit, ose Garanti i Kushtetutes, siç e njuh ligji ynë, gjendja është shume e rënduar në kete vend.

Pra, ardhja në pushtet e kësaj qeverie, nuk është as më pak as më shumë,

por instalim i një diktature dhe lulëzim i krimit të organizuar shtetëror, pasi personat me precedente kriminal, tashme janë deputet të Kuvëndit të Shqipërisë.

Kjo skemë krimi e instaluar në Parlament do jetë një pengesë drejt reformes në drejtësi dhe integritet të Shqipërisë në strukturat Euro-Atlantike, duke e bërë jetën e shqiptarëve gjithnjë e më të pasigurtë dhe duke u krijuar hapësira pushtetarëve të abuzojnë me pushtetin e dalë nga krimi e korrupsioni.



Banda kriminale sulmon katër qytetarë në mes të Tiranës

Pardje, rreth orës 13: 00 në rrugën “Ymer Ndrejoni” në Tiranë, dy persona me motor dhe skafandra në kokë, kanë dhunuar fizikisht Anëtarin e Këshillit Bashkiak të Fushë Arrësit dhe njëkohsisht i zgjedhur edhe si Anëtar në Këshillit e Qarkut Shkodër Selvator Gjoka. Ai ishte me makinë dhe po udhëtonte nga aeroporti “Nënë Tereza” së bashku me bashkëshorten Brunilda Doda, vjehrin Ndue Doda dhe vjehrrën Lina Doda. Sapo kanë zbritur nga makina, dy persona i kanë sulmuar befasisht. Njëri ka nxjerrë armën e zjarrit tip pistoletë dhe tjetri ka ushtruar dhunë fizike mbi shtetasin Selvator Gjoka, duke e paralajmëruar se herën tjetër do e vrasin nëse nuk heshtë. Dy kriminelët, sipas tre personave të tjerë prezent në ngjarje, kanë sqaruar se kanë

hesape për të larë vetëm me të quajturin Selvator Gjoka dhe me ata nuk kanë asgjë. E kanë lënë pa ndjenja në rrugë dhe janë larguar me shpejtësi. Të lënduarin e kanë dërguar urgjentisht në Qendrën Shëndetësore më të afërt, ku mjeku Dr. Sinan Manjani e ka trajtuar në sallën e urgjencës.

Sipas informacioneve të gazetës sonë Selvator Gjoka, me profesion mjek stomatolog, përfaqëson në Këshillin Bashkiak Fushë Arrës Partinë Drejtësi Integrim dhe Unitet, (PDIU) të njohur ndryshe si partia e çamëve. Është një forcë e vogël politike, e papërfolur për korrupsion dhe gjatë fushatës elektorale për pushtetin vendor 2015, Gjoka ishte vënë nën presionin e dy partive kryesore PD e PS si dhe të grupeve me prapavijë terroriste.

Grupe islamike me interesa kriminale e ekonomike pranë dy partive të mëdha, kishin bërë presion, që ky djalosh të mos sigurote votat popullore për në Këshillin Bashkiak. Por votat i kish marrë gjithsesi dhe në vazhdimësi kishte denoncuar fenomenin e drogës, duke ngritur shqetësimin se strukturat e shtetit nuk po asgjësojnë parcelat e kanabisit. Ky denoncim si duket i ka shqetësuar baronët e drogës, që në Veri të Shqipërisë katër vitet e fundit kanë kultivuar sipërfaqe të mëdha, të ruajtura me polici.

Në fakt, fenomenin e kanabizimit dhe korrupsionit, kohët e fundit e kanë denoncuar me forcë edhe Ambasadori amerikan Donald Lu dhe ajo e Bashkimit Europian, Romana Vllahutin. Shqipëria është kthyer në Kolumbinë e Europës. Shtete si Italia, Holanda, Belgjika, Greqia, Danimarka, etj. Kanë ngritur shqetësimin për bandat shqiptare të drogës, të lidhura me politikën dhe kanë propozuar edhe ndalimin e shqiptarëve në zonën SHENGEN. Shumë

oficerë policie tashmë janë arrestuar, por pas presionit të ndërkombëtarëve dhe survejimeve të medias. Gjithsesi, prokuroria dhe gjykatat, edhe ato të korruptuara dhe të lidhura me kartelin e drogës, kanë nxjerrë të pafajshëm me qindra peshq të mëdhenj, siç me të drejtë i ka emëruar Ambasadori Amerikan Lu dhe kanë lënë në burg vetëm ca punëtorë që paguheshin nga 10 deri 15 euro në ditë. Nga të dhënat e para, denoncimi i drogës nga Anëtari i Këshillit Bashkiak Fushë Arrës, i zgjedhur edhe si përfaqësues i atij komuniteti në Këshillin e Qarkut Shkodër, Selvator Gjoka, ka qenë shkak i dhunës fizike ndaj tij, natyrisht për t'i dhënë paralajmërimin e fundit për eliminim fizik. Rastet e vrasjeve të tilla janë të shumta. Nëse dikush denoncon bandat e drogës, eliminohet. Guximi kriminal është i frikshëm dhe i lidhur me klanet e fuqishme qeveritare.

Rama po bën masakër urbane. Ku është opozita, Blushi e Bojaxhi?

Nga Fatos Lubonja

Lexova para disa ditësh një lajm që buron nga revista ekonomike "Monitor", e cila, duke i referuar agjencisë ndërkombëtare të real estate "Collier International", zbulon se Shqipëria paska 235 m² sipërfaqe qendrash tregtare për çdo 1000 banorë, çka tejkalon edhe vende si Gjermania, Franca, Italia Spanja. Duke u nisur nga kjo e dhënë, komentohej bumi i lejeve të ndërtimit që po jep së fundmi dyshja Rama-Veliaj, si për kulla të larta e pallate banimi, si për ndërtimin e qendrave të reja tregtare. Paralajmërohej se këto mund të rezultojnë në fluska piramidale të rrezikshme për ekonominë shqiptare, sepse edhe në këto kushte disa qendra tregtare duken se kanë falimentuar, kurse për sa u përket apartamenteve për banim, rikujtoheshin deklaratat e Veliajt (kur premtoi zero ndërtime) mbi numrin jashtëzakonisht të lartë të apartamenteve bosh. Përgjithësisht pashë se deri këtu ndalonin komentet mbi rreziqet.

Gjykoj se një interpretim i tillë i rrezikut të asaj që po ndodh është i cekët dhe i mangët. Ne na duhet të gjejmë se ku fle lepuri i këtij projekti kaq paradoksal. Si ka mundësi që në një kohë që Shqipëria vjen e boshatiset nga njerëzit dhe varfërohet në blerje, këtu ndërtohet gjithnjë e më shumë sipërfaqe shërbimi për njerëzit? Kaq budallenj qenkan të ashtuquajturit investitorë sa i kthejnë paratë kot së koti në çimento?

Nëse do të thellohemi sadopak, hipotezat më të besueshme janë dy, njëra më e rrezikshme se tjetra.

Hipoteza e parë është se këto qendra tregtare e kulla ndërtohen nga aventu-



rierë që marrin para të madhe borxh nga bankat, një pjesë të të cilave e përdorin për ndërtimin e objekteve, kurse pjesën tjetër e fusin në xhepat e tyre. Pas kësaj, ata mund të shpallin falimentim duke ua lënë bankave objektin që kursesi s' do të mund ta shesin me një çmim që të kompensojë shumat që kanë lëvruar. Rreziku në këtë rast është që këtë diferencë ta paguajnë qytetarët nëpërmjet shtetit apo, edhe më keq, nëpërmjet kursimeve të klientëve. Në këtë rast jemi më afër konceptit të piramidave financiare të '97-s.

Hipoteza e dytë është se paratë me të cilat po ndërtohen këtë qendra e kulla nuk vijnë nga bankat, por nga krimi i organizuar, shkurt nga trafikantët e drogës që s'kanë se ku t'i investojnë dhe pastrojnë paratë e pista më lehtë se në Shqipëri.

Mund të kemi të bëjmë edhe me një kombinim të të dyjave, por personalisht besoj se peshën më të madhe në bumin e fundit e ka kjo e dyta. Kjo, së pari duke parë se kanabizimi i Shqipërisë ka arritur nivele rekord dhe, së dyti, pasi bankat, sipas ç' kemi lexuar, janë më të kujdesshme për të dhënë kredi me rrezikun që të kthehen në kredi të këqija.

Këtu problemi i problemeve është se si varianti i parë, ashtu dhe i dyti, nuk mund të realizohen pa bashkëpunimin me qeverinë. Sepse është ajo që po jep lejet e ndërtimit pa u shqetësuar as për burimin e këtyre parave, as për faktin se këtu kemi të bëjmë me një rrugë zhvillimi të ekonomisë krejtësisht të gabuar. Pse vallë? Dikush thotë se kjo vjen nga deliri i Edi Ramës që kërkon të identifikohet me kullat që po ngre në Tiranë. Por në këtë rast projekti do të kufizohej vetëm te kullat. Kurse këta po japin leje ndërtimi gjithandej, edhe në vende nga më të pabesueshmet që dukshëm shëmtojnë peizazhin urban, përveçse shkatërrojnë tokën e bukës dhe zhvlefësojnë vlerën e banesave ekzistuese. Pra, pyetja shtrohet: pse kupola e Partisë Socialiste, pasi na premtoi zero ndërtime në Tiranë është lëshuar në këtë masakër urbane? Shpjegimi më i arsyeshëm është se kjo kupolë dhe njerëzit e kriminit rreth saj, duke qenë të paafët të ndërtojë një ekonomi të shëndoshë në Shqipëri, kërkojnë të qëndrojnë në pushtet në sajë të parave të kriminit. Për Edi Ramën & Co nuk ka rëndësi se kjo e ashtuquajtur "rritje" nuk është gjë tjetër, veçse rritja e një tumori që

po pushton gjithnjë e më shumë trupin e shëndoshë të vendit, as se po u hapin gjithnjë e më shumë dyert e ekonomisë dhe të pushtetit njerëzve të kriminit me rreziqe të jashtëzakonshme për demokracinë, as se duke inkurajuar këtë kategori, po shkatërrojnë çdo sistem vlerash në këtë shoqëri. Me dritëshkurtësinë dhe guximin tipik të aventurierëve që jetojnë përditshmëri në pa menduar se ku po i çon rruga që kanë nisur, dhe aq më pak pasojat ndaj të tjerëve, ata kanë llogaritur se kjo para e pisët do të vërë sidokudo në qarkullim ekonominë, do të punësojë ca njerëz, do të shpërndajë ca para. Sigurisht, pa harruar paratë që fusin vetë në xhep, si dhe ato që duhen për propagandën brenda dhe jashtë vendit për të mbuluar krimin që po kryhet. Pra ky projekt, në dukje absurd dhe paradoksal, është një mekanizëm pushteti për pasurimin e kupolës dhe pasurimi për pushtetin. Nga pikëpamja ekonomike, ai na kujton të ashtuquajturën industri që krijoi regjimi komunist me ndihma sovjetike, pastaj kineze, e cila duke qenë krejtësisht jorentabël, i la shqiptarët duarthatë në fund të aventurës.

Çuditërisht, opozita që deri dje ulërinte për njerëzit e kriminit në Parlament, nuk është dukur të reagojë për këtë projekt, i cili qëndron në thelb të asaj se pse u mbush Parlamenti me njerëz të kriminit. As PD, as LSI, as opozitat e reja që lindën nuk po reagojnë ndaj tij. Ku është Ben Blushi, ku është Bojaxhiu? Duket sikur shqiptarët kanë shtypur butonin që i kalon në gjendjen e nënshtrimit total ndaj së keqes, si në kohën e diktaturës, dhe po presin Mesinë të vijë t'i shpëtojë. Kjo është një ëndërr nga e cila duhet të zgjohen sa më parë.

Maskat sulmojnë vajzën e mitur të policit

Dje rreth ores 13:00, në Perash të Shkodrës, afër shkollës 9-vjeçare "Martin Camaj, tre persona me maska kanë zbritur nga makina e tyre dhe kanë sulmuar një fëmijë të klasës së 8-të të kësaj shkolle, duke u përpjekur ta rrëmbejnë.

Në ato momente, në atë vend, për fat të mirë kanë qënë qindra prindër që pritnin të merrnin fëmijët pas mbarimit të mësimi. Ata janë përleshur fizikisht me kriminelët dhe kanë arritur që të miturën M. Dushi ta shpëtojnë.

Maskat, pasi kanë dështuar, janë larguar me shpejtësi duke bërë turr:

"Thuaji babait tënd se nuk do e falim, kush na ngacmon ne, e futim thellë në tokë"

Pra, dëshmitarë okularë që njihnin këtë fëmijë, deklaruan se babai i të miturës është efektiv i Policisë së Shtetit në Qarkun Shkodër prej shumë vitesh. Pasi huluntuam, mësuam se dje u sulmua fëmija e policit Admir Dushi. Ky polic ka patur kërcënime nga disa persona, pasi ka marrë pjesë në shumë aksione për asgjësimin e Cannabis sativa, sidomos në zonën e thellë malore të Dukagjinit.

Në fakt, në 26 vitet e fundit janë



vrarë në krye të detyrës më shumë se 200 policë. Bandat janë të fuqishme dhe kanë mbushur gjithë teritorin e vëndit me Cannabis sativa.

Policisë në Dukagjin i kanë qëlluar

me plumba edhe helikopterin në një aksion për asgjësimin e Cannabis sativa.

Redaksia e gazetës

Gazetari Artan Hoxha: Ja pika strategjike ku kalon droga afgane...

Pak ditë pasi makina e policisë së Elbasanit u përplas nga një mjet tjetër, është krijuar një debat i gjerë, lidhur me situatën në këtë qytet.

Gazetari Artan Hoxha, në rubrikën "Opinion", në "News24", thotë se, situatën në qytetin e Elbasanit nuk e përballon dot policia lokale.

Ai thotë se duhet një angazhim më i madh, pasi ky qytet është "nyje strategjike për kalimin e drogës".

"Në Elbasan është krijuar një situatë që nuk e përballon dot policia lokale. Ka patur përplasje të vazhdueshme në Elbasan. Është një nga degëzimet ku lëviz droga afgane.

Elbasani është nyje strategjike për drogën që hyn nga Kapshtica. Rupet kriminale kontrollojnë Elbasanin. Për ngjarjen e ndodhur dy ditë më parë me policinë, u përpoq që të mos bëhej zhurmë mediatike. U tentua që ngjarja në Elbasan të manipulohej", - shprehet gazetari Artan Hoxha.



Policia operacion antidrogë pranë shkollave, në pranga një i mitur

Ditët e fundit Policia e Kosovës ka zhvilluar një operacion antidrogë në Prishtinë, ku kanë kontrolluar disa lokacione afër shkollës së mesme 'Sami Frashëri' dhe shkollës fillore 'Elena Gjika'.

Në afërsi të lokaleve të kësaj të fundit pjesëtarë civilë të policisë kanë kontrolluar të rinjtë për substanca të dyshimta.

Zëdhënësi i policisë, Daut Hoxha e ka konfirmuar këtë operacion, duke shtuar se kontrole ka pas edhe në qytetin e Gjakovës.

"Ju konfirmojmë që edhe sot në rajone të ndryshme të vendit (si në Prishtinë dhe Gjakovë) janë realizuar operacione policore në funksion të parandalimit dhe luftimit të dukurisë së përdorimit, abuzimit me substanca narkotike dhe Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar edhe më tutje në vazhdimin e luftimit të kësaj dukurie për të krijuar një ambient më të sigurt për të gjithë qytetarët, në veçanti rininë dhe nxënësit", ka thënë Hoxha.

Ai ka shtuar se në Gjakovë, njësitet e policisë kanë arrestuar një person të mitur pasi i është gjetur sasi e substancës narkotike dhe rasti po vazhdon në procedurë të rregullt.

Ndërsa sa i përket rajonit të Prishtinës,



nës, Hoxha nuk ka dhënë informacion për ndonjë të arrestuar.

Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të parapara me Strategjinë Kombëtare kundër drogave dhe legjislacionit në fuqi në vazhdimësi gjatë këtij viti dhe viteve që po lëm pas ka realizuar op-

eracione të suksesshme policore në parandalimin dhe luftimin trafikimit me narkotikë.

Gjatë operacioneve policore janë konfiskuar sasi e konsiderueshme e substancave të dyshuara narkotike, janë arrestuar numër i madh i personave të dyshuar si dhe shpartalluar grupe kriminale. Policia në bashkëpunim edhe me autoritetet tjera rel-

evante në vazhdimësi po punon për parandalimin e rasteve të abuzimit me substanca narkotike, dhe në aspektin ligjor ne do të ndërmarrim masa të ashpra ligjore ndaj të gjithë atyre që janë të involvuar në trafikim apo abuzim me substanca narkotike dhe vepra tjera të kundërligjshme që rrezikojnë shëndetin e të rinjve tanë apo të nxënësve në veçanti.

Pse Rama nuk mund të jetë autokrat, pavarësisht se ka pushtetin i vetëm?

Nga: Spartak Ngjela

Sot po rishkruhet historia e Shqipërisë. Është historia e Arbërisë mi-jëvjeçare

Nuk e ndalon dot askush sot rigjal-lërimin e jetës së përbashkët të shqiptarëve në Ballkan. Historia do të rishkruhet. Vetë shteti shqiptar duhet të reformohet demokratikisht bashkë me rishkrimin e historisë së shqiptarëve: ky është një kusht i garantuar historik që nuk mund ta shkelë apo ta smbrapsë dot askush

Reformimi i shtetit shqiptar aktualisht është marrë në dorë nga Uashingtoni dhe Brukseli. Dhe kjo është ngjarja historike më e madhe për shqiptarët në 500 vjetët e fundit.

Por, na duhet të theksojmë që është Uashingtoni dhe Berlioni që e kanë bindur politikën perëndimore dhe vetë Brukselin drejt së vërtetës historike për Shqipërinë dhe për shqiptarët në Ballkanin Perëndimor

I.

Interesat e Perëndimit tani e kanë sjellë çështjen e Arbërisë në vendin e vet historik, dhe reformimi i shtetit shqiptar ka hyrë që të jetë një çështje historike në rrafsh botëror.

Po të shihet me vëmendje e kupton se, për politikën amerikane, në dekadat që do të vinë, e rëndësishme është reformimi i hapur territorial i Arbërisë. Kjo në fakt është Shqipëria territoriale.

Por, a e kuptojnë dot këtë liderët politikë shqiptarë të korruptuar në Tiranë? Jo, këta kalamaj janë kundër, dhe duan ta bllokojnë, dhe bashkohen për të kërkuar ndihmë në Athinë dhe Beograd kundër historisë së vendit të tyre.

Në fakt kjo është një ndërmarrje e falimentuar: reforma shqiptare dhe riafirmimi i çështjes shqiptare është i pandalshëm. Risjellja në qartësi të plotë e historisë mijravjeçare të shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor, është sot çështje thelbësore e politikës perëndimore. Për këtë arsye, edhe popullsia çame që jeton në Shqipëri në këtë kohë, duhet të jetë e sigurt se genocidi grek kundër tyre, shumë

shpejt do ngrihet ndërkombtarisht siç u ngrit në vitet nëtëdhjetë çështja e Kosovës. Nuk ka as Cipras, as Kocias dhe as Dule që ta ndalojë, sepse është një e vërtetë historike e cila është fshehur ndërkombëtarisht në mënyrë kriminale, duke përfshirë këtu edhe të gjitha qeveritë e Shqipërisë së pas Luftës së Dytë Botërore.

II.

Për të gjithë këtë që shprehëm, reforma shqiptare është e pamundur të ndalohet, por ndërkohë po shihet paqartësi edhe nga fituesi i zgjedhjeve të fundit. A do të kuptojë Rama që nuk drejton dot vetëm Shqipërinë dhe nuk

të pamundur që të veprojë. Kryeministri shqiptar aktualisht duhet ta ketë të qartë që ai nuk e ndalon dot reformimin perëndimor të Shqipërisë dhe ri-institucionalizimin demokratik të saj që do të vijë me anë të një drejtësie shqiptare të pavarur.

Të gjitha këto vinë në një ekuacion të qartë: bota sot nuk është as nacionale dhe as internacionale koha jonë është transnacionale. Ky transnacionalizëm ka ardhur dhe është pranuar në Shqipëri me aleancën shqiptaro-amerikane si interes i përbashkët në luftën globale midis Perëndimit dhe Lindjes

Përqëndrimi i botës shqiptare në

III.

Duhet një Reformë gjithshqiptare kulturore për afirmimin e gjuhës dhe kulturës së përbashkët në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Duhet të ngrihet prestigji shqiptar nëpërmjet marrëveshjes së shkruar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Duhet të krijohet sa më shpejt krijimi i unifikimit të të drejtave, në të gjithë legjislacionit, midis Prishtinës dhe Tiranës.

Duhet të krijohet sa më shpejt tregu i përbashkët Kosovë-Shqipëri.

Duhet të firmoset marrëveshja midis ministrisë shqiptare dhe kosovare të arsimit për unifikimin e arsimit dhe



ka më asnjë shans vazhdimi i autokracisë në Shqipëri? Pas kushtetutës së korrikut 2016, autokracia shqiptare nuk është më opsion. Deri tani autokracia shqiptare ka qenë forcë anti-shqiptare sui generis në Shqipëri: të gjitha kanë shitur interesin shqiptar te fqinjët. Kapitulli i autokracisë tanimë është i mbyllur në Shqipëri, kush e aspiron, është i humbur pa filluar kundërshtimin e reformës.

Çdo kryeministër shqiptar duhet ta kuptojë që bota shqiptare në Ballkan është sot epiqendra e politikës amerikane dhe europiano-perëndimore. Jashtë kësaj politike e ka absolutisht

Ballkanin Perëndimor duke përfshirë edhe popullsinë milionëshe arvanitase në Greqi, si interes parësor i politikës së Uashingtonit dhe Berlinit, e ka kthyer tani historinë në vendin e saj. Në funksion të kësaj bota akademike shqiptare duhet të grupohet seriozisht për interesin e lartë kombëtar, sepse në këtë kohë klasa politike shqiptare, jo vetëm që është e korruptuar në të gjitha portet e saj, por as intelektualisht nuk është në gjendje që i përgjigjet historisë së re, zhvillimit shoqëror shqiptar, që kërkon dije të thella perëndimore dhe aftësi të një niveli bashkëkohor perëndimor.

programeve të shkollave të ulta dhe gjimnazeve.

Duhet që kjo marrëveshje të imponohet për të gjitha shkollat shqipe në Mal të Zi, në Serbi dhe në Maqedoni. Qeveria shqiptare duhet të rivlerësojë marrëveshjen e viteve 30 me Athinën për arsimin shqiptar në të gjithë Çamërinë.

Duhet që shteti shqiptar t'i bëjë thirrje të gjithë shqiptarëve që kanë mbaruar iuniversitytet perëndimore dhe që punojnë në Perëndim të kthehen në Shqipëri sipas një rroge të niveleve perëndimore; madje, për elitën e tyre, edhe më të lartë.

Kryeministri Rama: Ne do të qeverisim në koalicion të madh me njerëzit!

PS, e cila fitoi bindshëm në zgjedhjet parlamentare të 25 qershorit, po shkon drejt përgatitjeve për qeverinë e re. Kemi marrë më shumë vota se katër

vite më parë, dhe një mbështetje e këtyre përmasave është një përgjegjësi shumë e madhe, tha kryeministri Rama gjatë takimit me deputetët e

rinj dhe kandidatët për deputetë. Duke paralajmëruar se mosjustifikimi i besimit do të ishte fatal për PS, zoti Rama bëri të ditur fillimin e një turi në bazë për të vlerësuar cilësinë e punës së administratës shtetërore. "Struktura dhe përbërja e qeverisë së re do të shpallet vetëm pas reflektimi ku hyjmë sot dhe deri në fund të gushtit kur do mbledhet asambleja jonë kom-

bëtare. Prandaj ju kërkoj të gjithëve të fokusohemi të ky proces shumë i rëndësishëm përgatitor për mandatin e ri dhe të nisim menjëherë në çdo qark dhe në çdo zonë administrative zgjedhore një tur dëgjimor me partinë dhe komunitetet zonë për zonë" tha zoti Rama. Ai tha se PS do të qeverisi në koalicion të madh me njerëzit.

Rënia tragjike e zgjedhjeve prej blerjes masive të votës

Nga: Preç Zogaj

Blerja masive e votës në zgjedhjet e ditës së diel nga PS, LSI dhe nga disa kandidatë të veçantë të partive me të vogla është e paprecedentë në historinë e demokracisë shqiptare. Në pikëpamje të efektit që ka pasur në rezultatit e zgjedhjeve shitblerja kapilare në fjalë i përfaqëson efektin që ka pasur rrethimi i zgjedhjeve me policë dhe shikas në vitin 1996. Me ndryshimin se atëherë rrethimi ishte i dukshëm, i hapur, në dritë të diellit dhe vota u tjetërsua kryesisht pasi u hodh.

Rrethimi i zgjedhjeve me paratë e drogës dhe korrupsionit njëzet e një vite më vonë ishte i fshehtë, perfid dhe vota u tjetërsua para se të hidhej. Për zgjedhjet e vitit 1996 është thënë se presionet dhe manipulimet nuk përcaktuan daljen në vend të parë të Partisë Demokratike të asaj kohe, por e ndotën fitoren e saj duke e zmadhuar përtej asaj që kishin vendosur zgjedhësit me votën e tyre. Për zgjedhjet e vitit 2017 mund të thuhet e njëjta gjë: Shitblerja e votës e ka fryrë rezultatit e PS dhe LSI dukshëm përtej asaj që do të kishte qenë me zgjedhje të lira e të ndershme.

Ky është një vlerësim relativ gjithësesi, që mund t'i afrohet ose jo së vërtetës. Manipulimi i zgjedhjeve, me dhunë apo me para, është i paprogramueshëm; është si puna e gruas shtatzënë për të cilën nuk mund të thuhet është pak me barrë, mesatarisht me barrë apo shumë me barrë. Ne nuk e dimë kurrë me saktësi sa mandate kanë shtuar në palmaren e tyre PS dhe LSI përmes blerjes së votës. Të zhytësh në këtë llogari është të biesh në kurthin e harxhimit të kohës kot.

Duhet të merremi me fenomenin. Fenomeni i shitblerjes së votës është mbreti lakuriq i këtyre zgjedhjeve. Të gjithë e dinë, të gjithë e kanë parë, të gjithë kanë prova dhe fakte nga pallati, lagjia apo fshati ku jetojnë. Por nuk i denoncojnë në polici. Sepse kanë frikë nga blerësit e dhunshëm që kanë vepruar e veprojnë në emër të kryeministrit Rama apo presidentit të zgjedhur Meta; sepse policia i lë në baltë; sepse të blerët janë rëndom të afërm apo fqinjë, të cilëve nuk duan t'u bëjnë keq duke i paditur.

Por ka një bindje të gjerë popullore se shitblerja masive e votës është shenja dalluese e zgjedhjeve të 25 qershorit. Me këtë shenjë, apo më saktë me këtë damkë, do të mbesin në his-

torinë e zgjedhjeve më të shëmtuara e më të pista që vendi ka njohur. Përveç morisë së pafund të fakteve "të vogla", këtë e provojnë edhe faktet e mëdha që nuk kanë nevojë të hetohen. Lumi i parave të drogës dhe korrupsionit që u përdorën për blerjen e votës në fushatën e këtij muaji tronditi kursin e këmbimit të euros, duke e zhvlerësuar atë kundrejt lekut më shumë sesa do ta kishte zhvlerësuar një sezon turistik



shumë i suksesshëm.

Një kambist në Lezhë rrëfeu se kishte këmbyer në dhjetë ditët e fundit të fushatës tetëqind mijë euro, një shumë e barabartë, siç tha ai, me punën e dy viteve. Përveçse me lekë, vota u ble direkt edhe me euro. Dy partitë e ish-koalicionit qeveritar, PS dhe LSI, vunë në shënjestër të fushatës së tyre zgjedhësit e ashtuquajtur vulnerabël, të kthyeshëm, të shitshëm, të varfër, të cilëve iu qepen natë e ditë për t'i lidhur në zinxhirin e votëblerjes. Kjo ishte në tërësi "fushata" në terren e pagatorëve, kujdestarëve dhe kapove zonalë të këtyre partive. Ata u përplasën disa herë për prenë, domethënë për zgjedhësit e piketuar për t'u blerë.

Për asgjë tjetër. Por shefat supremë të kësaj farse të re, të panjohur në tokën e Europës, janë Edi Rama dhe Ilir Meta. Banditët lokalë vepruan me bekimin e tyre. Mjerisht, marrëvesh-



ja Rama-Basha nuk zgjidhi asgjë në lidhje me problemin më të madh të zgjedhjeve shqiptare, për të cilën PD dhe opozita protestuan për nëntëdhjetë ditë me radhë në çadër. Në të kundërtën, duke ulur tensionet politike, marrëveshja e lehtë-soi shitblerjen e votës, e bëri gati komode.

Vullneti i mirë apo përkushtimi i ministrit të Brendshëm, zotit Demiraj, shteroi përballë një infrastrukture pol-

vendin dhe demokracinë është ku e ku më i madh se rezultati apo humbja e opozitës. Defektet e PD-së janë çështje të riparueshme të një pale. Kurse instalimi i shitblerjes së votës përmes një mekanizmi kriminal që riciklon pa pushim varfërinë dhe vdekjen e shpresës është një çështje e madhe e ekzistencës ose jo të vetë demokracisë. PD është përfshirë këto ditë në debatet për lidhshimin.

Le të vazhdojë debati, por paralelisht PD duhet të ndërmarrë me urgjencë një proces faktmbledhës për të ndërtuar një raport të plotë e të hollësishëm të shitblerjes së votës, duke identifikuar e denoncuar një për një, me emër dhe mbiemër, blerësit e votës, lidhjet e tyre me shefat politikë në Tiranë, shpërblimin që kanë marrë e po marrin për këto bëma kriminale. Në bazë të këtij raporti PD duhet të përcaktojë një qëndrim të drejtë ndaj zgjedhjeve të 25 qershorit në përgjithësi dhe fenomenit të shitblerjes së votës në veçanti. Do të ishte një tradhti e madhe ndaj detyrës dhe sakrificave të demokratëve nëse kjo gjë kalon me disa deklarata.

Angazhimi i opozitës është një imperativ, por kjo nuk mjafton. Shitblerja e instaluar e votës vështirë se zgjidhet me votë. Problemi ka hyrë në rreth vicioz. Shitblerja po vret reaginimin e qytetarëve me votë ndaj bilancit të qeverisë apo programeve të opozitës. Kjo është dramatike, e ngjashme me heqjen e votimit të fshehtë. Kjo e cenon demokracinë dhe qëndrueshmërinë e vendit po aq sa do ta cenonin armiqët e Shqipërisë. Partnerët amerikanë do ta vlerësojnë me seriozitet të madh këtë situatë të rëndë dhe do ta ndihmojnë Shqipërinë për ta kapërcyer.

Partnerët europianë gjithashtu. Jo duke firmosur me shkujdesjen e verës zgjedhjet e damkosura nga shitblerja. Por duke vënë gishtin në plagë me drejtësi e dhimbje; duke treguar me emër përgjegjësit e farsës së re. Të dielën zgjedhjet shqiptare, thellësisht të pabarabarta dhe dukshëm të dhunuara me paratë e drogës dhe korrupsionit, u futën sërish në terr. Njëlloj si ato të vitit 1996 apo të vitit 2001. Historia na ka mësuar se pas territ i vjen radha stuhisë. Askush që ka vendosur të jetojë dhe të vdesë në këtë vend nuk do të pajtohet për asnjë arsye me asgjësimin e zgjedhjeve të lira. Pa të cilat nuk ia vlen të jetojë, thoshte Izajak Berlin.

icore të bërë njësh apo të nënshtuar ndaj bandave zgjedhore. Në fakt, siç rrodhën ngjarjet, për PD dhe opozitën do të kishte qenë më mirë të shkonte në zgjedhje në luftë me qeverinë sesa në paqen që prodhoi marrëveshja. Është e vërtetë se Lulzim Basha vuri Shqipërinë të parën. Por Edi Rama vuri timonin e tij të parin. Në këtë pikë Edi Rama është besëpreri i madh i Lulzim Bashës.

Por Bashën nuk e futi Edi Rama në zgjedhje. Ne të gjithë e dimë se opozita u fut në zgjedhje me ndërmjetësimin e SHBA-së. Duke lejuar e inkurajuar taborret e tyre të blejnë vota me paratë e drogës dhe korrupsionit, Edi Rama i pari dhe Ilir Meta i dyti kanë prerë në besë, para së gjithash, ndërmjetësuesit e marrëveshjes, zyrtarët e lartë amerikanë që u angazhuan për zgjidhjen e ngërçit zgjedhor në Shqipëri. Partnerët tanë amerikanë nuk kanë si të jenë indiferentë për këtë.

Ka shumë gjëra që nuk kanë funksionuar në PD. Kam opinionet e mia për përgjegjësitë e Lulzim Bashës. Do të shkruaj për to. Por shitblerja masive e votës në këto zgjedhje është një krim i stërmadh zgjedhor, është një fatkeqësi kombëtare, dëmi i së cilës për

Është e sigurt, Rama e Basha do të qeverisin bashkë. Ja biseda që kanë bërë bashkë

Nga Mustafa Nano

Rama e Basha mund të na fshehin detaje të marrëveshjes që kanë bërë me njëri-tjetrin, por nuk na kanë fshehur dot faktin që ata kanë vendosur të qeverisin së bashku pas zgjedhjeve. Puna ua ka dashur të mos e pranojnë publikisht këtë gjë, pasi vetëm kështu do mundin të optimalizojnë rezultatin elektoral (socialistë e demokratë do ishin më të motivuar, nëse nuk do ta dinin se ekziston kjo marrëveshje), por kjo gjë është marrë vesh, tanimë. Nuk kanë mundur ta fshehin. Për ta fshehur, do iu duhej të luanin teatrin e ballafaqimit të fortë elektoral, me akuza, përbaltje, urrejtje, fyerje, tallje, përqeshje, britma, siç kanë bërë gjithnjë deri në momentin që kjo marrëveshje u arrit. Mirëpo ky rol, përveçse do ishte i mundimshëm për secilin syresh, do t'i bënte edhe qesharakë pas zgjedhjeve, kur ata të takoheshin, siç do të takohen, për të formuar qeverinë e tyre të përbashkët.

Madje, çfarë të bind më së shumti se kjo marrëveshje ekziston është mënyra se si ata po e zhvillojnë fushatën. Janë krejt të shtendosur, të relaksuar, si të jenë duke bërë një sauna a një banjo turke, e jo një fushatë elektorale. Nuk po merren fare me njëri-tjetrin. Edhe kur merren, e bëjnë me një gjuhë miqësore, anekdotike. Puç-puç njëri, puç-puç tjetri. Basha e të vetët nuk po denoncojnë probleme të qeverisjes së katër viteve të shkuara. Socialistët nuk po thonë asgjë prej atyre që kanë ditur për Bashën deri në këtë çast.

Vetëm LSI-ja është nervoze dhe është ky nervozizëm i saj që i ka dhënë pak ngjyrë fushatës e garës. Sikur të mos ishte për tonet e ngritura të LSI-së, e gjithë fushata do të ngjante me një harbim a orgji, siç ngjan qeverisja, kjo e fundit ta jep edhe më qartë idenë e orgjisë, pasi është treshe. Por deri në zgjedhje do vazhdojë kjo punë. Më pas, LSI-ja do fillojë të luajë rolin që i kanë lënë për të bërë, atë të armikut. Thënë ndryshe, atë të opozitës. Është gallatë e madhe kjo që ka ndodhur, apo jo? Demokratëve, gjatë gjithë kohës së çadrës, por edhe më herët u qante syri për pak flirt me LSI-në. Po se mos vetëm atyre. Edhe me socialistët ishte e njëjta gjë. Rama iu vardis pa fund Metës me synimin për ta rinovuar koalicionin, e kështu të fuste në xhep fitoren e sigurt, ashtu si në vitin 2013. Mirëpo, Meta u tregua "i pamëshirshëm". Ua mori shpirtin të dyve. Pse vallë? Për të rritur pazarin, kuptohet. Sa më shumë t'i luteshin, aq më të lehtë do ia bënin LSI-së negociatat mbi ndarjen e – po përdor një term

të shpikur prej Ramës – tepsisë. Me sa duket, Rama u lodh nga kjo gjë, dhe ka pritur rastin më të parë për një hakmarrje (Meta është duke ngrënë veten me dhëmbë tani që nuk qe në gjendje ta parashikonte këtë lëvizje). Vendimi i LSI-së për t'iu bashkuar opozitës në takimin e organizuar nga Duka-Mediu ka qenë për Ramën pika e ujit që derdhi kupën. Rama kuptoi në këtë rrethanë se nuk i bënte fare punë tërë ajo mbështetje ndërkombëtare që kish

kënaqësia. Është një gjë që as ai nuk e kishte menduar.

Rama: Ndërkohë, pas zgjedhjeve bëjmë edhe një ligj të ri elektoral të tipit mazhoritar. E kështu, ndërtojmë një sistem politik me dy parti. LSI-ja shkon në të sëmës.

Basha: Ok. Por duhet të flas me Berishën.

Rama: Fol tani. Ja ku e ke telefonin. Por jam i sigurt që Berisha do ta pëlqejë shumë këtë variant.



pas vetes. Ai po ndihej si qyqe, fillikat. Kështu i dha dum punës të shkojë edhe vetë në atë takim. E rrugës, prej kryeministrit deri te zyrat e Kuvendit, ka menduar zgjidhjen. Unë e kam shumë të qartë se ç'bisedë është bërë mes Ramës e Bashës larg syve të të tjerëve. Jam i sigurtë mú sikur të kisha vënë një *microchip* përgjimi në dhomën ku kanë qenë ata. Ja biseda që është bërë:

Rama: Çfarë kërkon nga unë që të futesh në zgjedhje?

Basha: Kërkoj të më ofrosh edhe njëherë paketën McCallister, plus ndonjë gjë tjetër. Ndryshe, i bie që të futem në zgjedhje i zgërlaqur. Do ishte fundi im.

Rama: Do të jap më shumë se aq. Do të jap zv.kryeministrin, ministrin e Brendshëm, disa ministra të tjerë, e në fund edhe drejtorë të rëndësishëm.

Basha shqyen sytë.

Rama: Por kam menduar diçka më të madhe se sa kjo. Ne nuk mund ta lëmë veten peng të Ilir Metës. Propozimi im është ky: "Ta qeverisim vendin së bashku, kryeministër bëhet kryetari partisë që merr më shumë vota; kështu, edhe nëse del keq në zgjedhje, zërat kritikë brenda partisë nuk kanë se çfarë të të bëjnë, pasi ti po e çon PD-në drejt pushtetit".

Basha: Ok. Sytë i lëshojnë xixa nga

Basha merr telefonin. Rama i shtyp tastin e altoparlantit, në mënyrë që të dëgjojë se çfarë thotë Berisha.

Berisha (pasi dëgjon Bashën që e informon se çfarë i ka ofruar Rama): Lulzim, kjo është shumë e bukur për t'u besuar. Mos e zgjat shumë. Shtrëngoji dorën Edit dhe quaje të mbyllur këtë punë.

Kjo lëvizje e Ramës në sekondën e fundit e ka shastisur Metën, i cili për këtë arsye e mbajti frymën te Berisha. Me shpresën se do gjente një Berishë të tërbuar që kishte mbetur jashtë loje, për rrjedhojë një Berishë të gatshëm për t'u lidhur në një aleancë me Metën, e për të krijuar një dialektikë të re në jetën politike: Meta & Berisha versus Basha & Rama. Por Berisha ka qenë më i qetë se kurrë. Nuk kish pse të mos ishte i qetë. Ai është pjesë e marrëveshjes. Këtu është Meta që ka kuptuar se ka mbetur si qyqe. Si është politika shqiptare, ë? Vetëm disa orë më parë, Meta ishte si Qabeja, nga kthenin sytë të tërë. Ndërsa pas marrëveshjes Rama-Basha, atij i duhet ta fillojë edhe njëherë çdo gjë nga fillimi. E sikur të mos mjaftojë kjo, atij i kanë lidhur këmbë e duar. E kanë zgjedhur President. Posti i Presidentit është kulmi që mund ta aspirojë një politikan. Do duhej të ishte një moment ngazël-

limi për secilin. Por jo për Metën. Në këto rrethana, Presidenca po i bëhet Metës si një kafaz. (Meqë ra fjala, ai duhet t'i japë një zgjidhje sa nuk është vonë kësaj gjëgjëze. Nuk mund të jetë edhe President i Republikës, edhe kryetar i LSI-së. Nëse ka për zemër LSI-në, le të japë dorëheqje sa nuk është vonë nga posti i Presidentit, pa u futur ende në zyrë: Nëse përkundrazi e ka me qejf punën e Presidentit, duhet ta lërë qysh tani LSI-në të bëjë çfarë i

mbetet për të bërë).

Njerëzit të gjithë pyesin, megjithatë: A ka të mirë vendi nëse qeveriset nga koalicioni PS-PD? Mund të kishte të mira, nëse marrëveshja Rama-Basha do të bëhej nën motivime pozitive e nëse ajo do të kishte një frymëmarrje të gjerë. Nëse marrëveshja është e dominuar nga meraku i të dyve për të pastruar fushën nga të tretët, nëse marrëveshja është ngritur mbi merakun për të mbajtur – po huazoj sërish diçka nga terminologjia e Ramës – kontrollin mbi tepsinë, do të ishte e kotë, madje idiotike, të pritej ndonjë gjë e hairit. Përkundrazi, nëse është ky lloj merak, një koalicion PS-PD ka për të qenë më për drej se sa kanë qenë koalicionet PS-LSI e PD-LSI. Një koalicion të tillë e shpëton vetëm një rrethanë, në të cilën Rama e Basha të jenë marrë vesh për të filluar një erë të re në politikën shqiptare e për të ndër-tuar – siç thotë Basha – një republikë të re. Mirëpo, janë të gjitha gjasat që të mos jetë kështu. Nuk mund të presësh që të fillojnë krejt papritur një epokë të re apo një luftë të re kundër "pengmarrjes" së qeverisë apo të qeverisjes, dy njerëz që deri në momentin që u morën vesh ishin në garë me njëri-tjetrin për t'i fituar zemrën "pengmarrësit".

Prek Cali: Patriot apo tradhëtar?!

Nga: Sokol Pepushaj

Ka shpërthyer një debat i fortë rreth njëres nga figurat emblematike të histories sonë, Prek Cali. Kulla e tij në Vermosh u kthye në një “mollë” shëri dhe nostalgjikët e Enver Hoxhës, Mehmet Shehut, Ramiz Alisë nisën të hapin “dosje” viktimash dhe ta interpretojnë Luftën Tamarës, thua se është ende Enveri gjallë. Është momenti t’u jepet përgjigje disa pyetjeve por edhe të respektohen heronjtë që mbrojtën nderin e trojet e veta nga pushtuesit e çfarëdongjyre:

1- Pse brigada e Mehmet Shehut sulmon me armë Kelmendin në janar 1945, kur Shqipëria ishte çliruar që më 29 nëntor 1944?

2- Si e priti këtë mësymje prijësi Prek Cali dhe cilat ishin idetë e qëllimet e tij?

3- Si e drejtoi operacionin Enver Hoxha në një Shqipëri të çliruar?

4- Pse lufta vazhdoi e ashpër dhe u kërkuan përforsime dhe atje mori pjesë edhe Ramiz Alia?

5- Si u veprua me robërit e luftës?

6- Cilat qenë pasojat e kësaj krahurë mes shqiptarësh dhe kush i ndërseu masakrat, ndoshta edhe të panevojshme?

7- Cilat ishin masakrat e tmerrshme të Mehmet Shehut pas arrestimit të prijësit kelmendas Prek Cali dhe përfundimit të luftës?

Në mes të këtij debate kaq të ndezur kombëtar për njëren nga figurat emblematike të histories shqiptare në kujtesë të troket një pjesë histori. Të troket ajo histori shqiptare brilante që për dekada të tëra enveristët na e servirën si antishqiptarizëm. Le të nderojmë pak çaste Kelmendin, truallin që lindi e rriti patriotin, viganin, apostullin e pashoq të shqiptarizmit.

Pra, Kelmendi, zona më verilindore e Shqipërisë, ky truall i Eposit të Kreshnikëve përkundi në fillim djepët e legjendave të Mujit e Halilit. Në majmalet e tij e kishin strehëzën zanat e malit e shtojzovallet. Mespërmas krahinës, në të dy anët, nga zona e Vuklit dhe ajo e Selcës, e përshkojnë dy lumenj, dy Ceme vrapkulçedër e sypringjelbër që bashkohen në Tamarë, duke u dhënë brigjeve një hijeshi si rrallëkund. Treva veriore u shemb e u shkruhua tre herë me rropamë, e po me aq madhështi u ngrit si një Sfinks gjigand. Aty holli shtat Nora, ajo vajzë me butësi trëndafili e zemër luaneshe, vajza e luftëtarit selcjan Vuk Marash Uci, ajo sokoleshë që hyri me dinjitet në analet e histories sonë, ajo Orë Mali që i preu kryet Pashait osman, Vuçi Pashës mu në qendrën e tij ushtarake, në Zall të Bruzit, në hyrje

të fshatit Selcë, në prezencë të plot 30.000 nizamëve. Aty lindi e shkroi histori Nikë Leka, Kryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, aty lindën e u rritën atdhetarë që ngritën flamurin e parë në historinë shqiptare. Është fjala për qëndresën antiturke të vitit 1911, ku Ded Gjo Luli e Prekë Cali, duke favorizuar ndërkombëtarisht me anë të një peticioni kryeneç dhe logjik çështjen shqiptare pranë qeverisë britanike, ngritën flamurin në Deçiq më 6 prill 1911 dhe mbajtën kuvendin e krerëve shqiptarë në Gerçë dhe miratuan “Librin e kuq” me 12 kërkesa drejtuar qeverisë Osmane që parapri në dhe përgatitën terrenin për ngritjen e flamurit në Vlorë, më 28 Nëntor 1912 nga Ismail Qemali e Luigj Gurakuqi, ashtu sikundër thotë edhe kënga: “Përmbi Selcë vargojnë do male / Thikë përpjetë si mur kalaje / Bash njaty kuvendi mldohi / Ma të mirët e ktij trolli / Përreth ahut shekullor / Zbardhin tirqet bardh si borë / Oshtijnë malet, ndalin gurrat / Gju më gju kuvendojnë burrat / Le ta dijë Perandoria / Ma nën zap s’duron Shqipnia”.

Në Kelmendin e Prekë Calit, në atë truall që ndjen nder të jesh bir i tij, u lind e u rrit edhe Françeskë Albanessi, sculptor e erudit i Rilindjes Italiane. Ky mjeshtër i gdhendjes u bë i pavdekshëm me Altarin e Kryekishës së Milanos që nuk është thjeshtë një monument kulti, por një ndër veprat më në zë të kulturës botërore. Aty rriti shtatin e vet edhe famozi Angjelin Prelocaj, miku më i ngushtë dhe më i vlerësuar i Ismail Kadaresë, njëshi i baletit në botë, i cili iku kur e ëma ishte shtatzënë 3 muajshe dhe sot jeton në Paris. Historia e tij është e sojme, e përafërt me atë të Gjekë Marinajt që po trondit globin me poezitë e tij.

Diku atypari, në Rapshë të Hotit, At Gjergj Fishta nisi vargjet e para të “Lahutës së Malcisë”. Diku në luginat e Kelmendit heroik, pikërisht në Nikçin e të parëve të Ibrahim Rugovës e Rexhep Qoses, armëtarët e hershëm shpikën e prodhuan topin prej dardhe me barut autokton. Por njëri nga kulmet, mbase më i larti, me të cilin mburret ky vënd i lashtë sa krijimi i ujit e ajrit, Qiellit e Tokës, është fakti se lindi, rriti, burrëroi heroin tonë kombëtar Prekë Calin, i cili siç do dëshmojmë në këto pak rreshta me fakte të gjalla, shkroi histori. Këtë histori brilante, diktatura enveriste megjithëse e syrgjynosi, s’mundi jo vetëm t’a fshijë, por as ta eklipsojë. Prek Cali do të shndërrohej në një përbindësh për cilindo që tentoi të skllavëronte, nëpërkëmbte apo ndërmerre ndonjë masakër kundër vendlindjes së tij të shtrenjtë e bashkë me të, mbarë truallit shqiptar.

SHQIPËRIA PA VERMOSHIN, NJË TRUP PA KRYE

Figura të tilla si Prekë Cali, edhe shtete i Franca, Italia, Amerika do i kishin nder. Zbërthimi i një figure të tillë, natyrisht kërkon kujdes të veçantë, por ne mund të themi pa droje që ai kishte një intuitë dhe atdhetarizëm që rrallë i gjen shoqe. Nuk mundi kurrsesi ky martir t’i besonte megallomanisë së pushtuesve, pasi në platformën e tyre gjithëherë është shtuar këmbëkryq rreziku proslav për kombin. Ky burrë i mençur e trim si zana, ka mbajtur në gjoksin prej viganit dokumentin me vulat e shtatë Krajlive të Europës, çka është rast unik në tërë historinë tonë. Si përfaqësues i palës shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, ai punoi me diplomaci në shërbim të çështjes shqiptare. Prekë Calit nuk iu tremb syri as në qelitë e errëta ku e përplasi regjimi i Ahmet Zogut, pasi ai ishte një mbështetës i fuqishëm i lëvizjes së qershorit 1924, krah Fan Nolit.

Ahmet Zogu tregoi një politikë të butë me Preken. Pra vetëm katër vjet qëndroi në burgun e Gjirokastrës. Gjatë asaj kohe Prekë Cali bëri “mik” edhe një fëmijë, Enver Hoxhën, të cilin edhe e shpëtoi, e nxori para kohe nga qelia me ndërhyrjen e tij direkte tek Mbreti, pasi mendonte ta kishte më vonë në krah të tij. Por Prekë Cali kish ndihmuar persekutorin e më vonë armikun e kobshëm të tij, pasi kahet e tyre u ndanë shumë shpejt. Pra, mirënjohja, burrëria, shqiptarizmi s’mund të bujtte në zemrën dhe shpirtin e zi të Enver Hoxhës. Kohë më vonë Enver Hoxha shkruan në kujtimet e veta:

“Kam patur një “mik” të mençur e trim. Vinin nga shumë shtete dhe e takonin në burg. I merrnin mendime e i bënin portrete. Por ai na dolli kundra, na dolli tradhëtar e kështu u detyruam ta eliminojmë...”

Edhe krerët serbë ishin betuar se do t’ia prisnin kokën Prekë Calit. Ata nuk e harronin kurrsesi aktin e vrasjes së përfaqësuesit të interesave serbe për vendosjen e kufijve në terren më 9 nëntor 1921, Mark Galit, siç edhe përjetësohet për të mos vdekur kurrë në këngë ajo madhështi shqiptare:

“Atë nëntor kur u vu kufi / I theu qafën gjeneralit t’ij / Marka Galit t’Malit t’Zi...”

Kështu pra, Malësia e Shkodrës ngeli tokë shqiptare sot e kësaj dite falë vendosmërisë deri në flijim të Prekë Calit, akt të cilin shqiptarët e New Yorkut e këndojnë në raste festash kombëtare e edhe gëzimesh familjare. Nga vargjet e gazetarit Pjetër Mernaçaj, shkruar më 1974, natyrisht me ndonjë përshtatje të vogël, për të cilin miku ynë Mernaçaj jemi të bin-

dur se na kupton, shkëputim: “Fjala nuk zgjat, u nis kuvendi / Këtu tha Preka, nuk asht vendi / Me ngul gur, me vu kufi / Ky asht dheu i t’parëve të mi / E, rrëhet keqas kush mendon / Se këto male i kapton / T’tan malësia asht betua / Deri sa krejt të jem farua / Një pëllëmbë tokë t’huejt mos m’ja lëshua / Një angleze, grua fisnike / Kur dëgjon ato fjalë kreshnike / Pak përmallshëm Preken e ka dvetë / Pse ti Cali kaq me t’nxehtë? / Pse i del zot këtij vendi të shkretët? / -Moj sojnikë t’u ngjattë jeta / Për Shqipni janë male t’vlehtë / Janë pyje, me kullota / E kund ma t’bukura s’i ka Bota / Brez mbas brezi, unë e di / Ktu kanë këndua t’parët e mij / Gjithmonë t’huejt na kanë ngatrrue / Deri n’vorre na kanë çermue... / Komisioni ra n’mendime / Hajt pra, Beg, po t’lam me pri / Njaty Preka vu kufi”.

Proverbial për të gjithë brezat ka ngelur postulati i tij në një konferencë diplomatike në Londër rreth çështjes së kufijve:

“Shqipëria e vogël ka burra të mëdhenj. Ajo pa Malësinë e Shkodrës do të ishte një trup pa krye...”

Nazistët gjermanë në vitet e pushimit fashist, i ofruan grada e poste të larta Prek Calit, me kusht që ky të syrgjynosej larg trojeve të veta. Këtë ofertë nuk kish se si ta pranonte vigani i maleve shqiptare. Ai qëndroi në viset e veta, i mbështeti këmbët fort në tokë, si Anteu, grumbulloi rreth vetes shokë të idealit kombëtar si Prelë Tomën (Smajlaj), Dedë Gjonin, Ndue Gjorapukën, Gjekë Selcën, Gjergj Lulën, Nikollë Preçin, Dedë Lulash Smajlin, Gjokotë Ujkën, Maç Lucën, Fran Doshin, Fran Pretash Zogun e shumë atdhetarë të tjerë. Në janar të vitit të parë të pasçlirimit, prijësi i maleve organizoi në fshatin Brojë një kuvend të krerëve të zonës për të koordinuar veprimet kundër uzurpimit, i cili identifikohet me synimet gllabëruese të serbomalazezëve. Prekë Cali, trim sa vetë trimëria, i meçur sa vetë meçuria, i matur sa vetë maturia, i urtë sa vetë urtësia, mban lidhje tepër të ngushta me personalitetet britanike, pasi me ndihmën e tyre synonte të realizojë ëndrrën e tij të kahmot:

“T’i kthejë sytë nga Perëndimi”, pasi sipas filozofi së tij, vetëm atje gjendej burimi i qytetërimit dhe i të mirave materiale. Meritë e Prekë Calit ishte dhe krijimi i relatave aq të ngushta me prijës së tillë si Abaz Kupin, Jup Kazazin e burra të tjerë të shquar të kombit shqiptar.

Cili është “faji” i Prek Calit për luftën e Tamarës?

Pas përpjekjeve të dështuara të Prekë Calit për një marrëveshje me udhëheqësit e forcave partizane, pasi

tashmë me Enver Hoxhën ishin të deklaruar kundërshtarë deri në vdekje, a përtej saj, zbret muzgu i 10 janarit 1945;

Brigada e Parë me komisar Fejzi Micolin, i turret Kelmendit. Fshati Brojë zihet në befasi, në gjumë. Mark Gjeloşi i Rahovicës lëshon kushtrimin në Vukël e Nikç. Thirrja kumbon në çdo kullë malësore dhe tek Ura e Tamarës, aty ku katërqind vjet më parë ishin mbytur me gurë tre taborre osmane, në mëngjesin e pazbardhur të 11 janarit, gjithë burrat, madje edhe gratë, u bënë grusht për të mbrojtur tokë e nder. Këtu, prijësi Prekë Cali kërkon ballafaqim për t'i mbyllur plagët e gjakderdhjes e për të çuar një komision tek Enver Hoxha për të nënshkruar një udhë logjike për të ardhmen e Shqipërisë. Por logun e bisedës për mirëkuptim, dialog, paqe, ardhmëri, e turpëron breshëria e plumbave të pabesë. Vetë komisar drejton tytën për kah gjokset e malësorëve. Në çast, si vetëtimja që çan qiellin, gjokset ngjeshen e bëhen shkëmb, e plumbave u përgjigjen me plumba. Bora skuqet nga grykëhollat e para. Trupi pa jetë i komisar Fejzi Micolit varet si leckë e qullur në yzengjitë e mushkës që hingëllin. Akulli përreth nis e shkrihet nga gjaku i pafajshëm shqiptar. Ç'tragjedi mesjetare e kohëve të reja?! Tërë ditën vazhdon shkëmbimi i zjarrit. Në mbrëmje vonë enveristët tërhiqen me panik e gjynahe për viktimat pa faj



të një ideje, që siç do vërtetohej më vonë, izoloi e paralizoi Shqipërinë. Megjithë humbjet e mëdha në të dy polet, por sidomos të uzurpuesve, si dhe të 52 robërve mësymës në duart e Prekë Calit, Prijësi Legjendar i Maleve, i cili edhe në Shkodër kish lënë histori duke çelur shkolla e objekte kulturi, kisha e xhamia, nuk ngurron të thërrasë sërish:

“T’i mbyllim plagët e gjakderdhjes, të hartojmë një plan të mesëm se jemi shqiptarë...”

Pala tjetër nuk latohej. Gjithsesi, është në nderin e burrërinë e malësorëve që 52 robërit e zënë, pas mjekimit me kujdes të plagëve e trajtimit shumë të mirë e njerëzor, i përcollën e i çuan deri në familjet e tyre. Ka patur nga ata robër që kanë vajtur deri tek Enver Hoxha dhe kanë treguar mençurinë e burrërinë e Prekë Calit. Enveri, pasi i ka dëgjuar, i ka pushkatuar!

TJETËR PABESI E TERROR

Pesë ditë pas kasaphanës së parë, ethet e çmendura të hakmarrjes, i ndërsejnë krerët e brigadës së parë. Marrshimi drejt viseve të Shqipërisë Veriore, ndërmerr një inkursion me

përmasa tepër të mëdha.

- O kriminelë pa fe e Atdhe, këtu më keni, tek Gryka e Shtegut të Kaut, - shpërthen një oshëtimë që rrok kullat e maleve. Ky zë gurgullon nga zemra e Prekë Calit e trimave të tij në pritë, të gatshëm për të dhënë jetën për vatan e ide. Lufta plas. Qëndresa e bijve të Malësisë që nuk duan gjakderdhje, është heroike, e pashembullt. Për tre ditë e tre netë pa ndërprerje, duhma e rëndë e barotit infektoi ajrin e pastër të Bjeshkëve. Malësorët nuk e njohin “artin” e rënies në gjunjë para askujt, sado katil e i armatosur të jetë. Të 67 vitet mbi kurrizin e Prekë Calit zipo-

hen, ndoshta tek 20-ta.

Përvoja jetësore e ka brumosur t’i urrejë në kulm e themel pushtuesit e çdo ngjyre qofshin. Strategjia e taktika e Prijësit Legjendar nuk maten me kutin e asnjë gjenerali tjetër. Nëpër luginat e Kelmendit, në ato tre ditë katrahure, pellgjet ujore të Cemit patën në brendësinë e tyre grumbuj kufomash, normalisht të pafajshme, por që luftonin për ide me qasje të kundërta.

Mallkuar qofshin ata që e shkaktuan atë konflikt të panevojshëm e bënë të derdhet gjak i pafajshëm e i pastër shqiptari, si ai i Xhuk Tomës nga Broja, Kolec Ucit (Curanaj) nga Vishnjeva, Lucë Gjon Ucit nga Vukli, etj. Oh, lufta si lufta; plagët ishin të rënda, humbjet të dhimbshme. U vranë shumë, u plagosën shumë. Luftëtarët Lukë Toma nga Vishnjeva e trimërisë, e Dedë Gjon Bajraktari nga Vukli historindritur, të plagosur për vdekje, u çuan në një kullë mikpritëse, me këngë, jo me vaje, pasi malësorët në shekuj kanë lindur me krismë pushke dhe e kanë mbyllë dërrasën e arkivolit vetëm me këngë. Brezat e përcollën sokëllimën e Prijësit të Pavdekshëm Prekë Calit:

“Trojet e të parëve tanë nuk guxon kush t’i nëpërkëmbë.

FRERËT E OFENSIVËS I MERR NË DORË ENVER HOXHA

Është fillim shkurti 1945. Veriu i Shqipërisë ende nuk i është nënshtruar Enver Hoxhës, paçka se “çlirimi” ishte zyrtarizuar me kohë. Njerëzit sot janë të gjallë. E mbajnë mend fort mirë kur frerët e ofensivës i mori vetë Enver Hoxha, pasi tërë malësia luftoi e derdhi gjak në ato përpjekje titanike e prijësit e Shkodrës e familje traditëshuma ndenjën në kontakt me ngjarjet atje. E pra, duhej mposhtur me çdo kusht “kryeneçësia” malësore, duhej çliruar Shqipëria! Po nga kush, bre? Çuditërisht nga shqiptarët.

Pra, për atje u nisën brigada e batalione të tëra. Kështu, kriminelin Mehmet Shehu sulmon nga Rapsha. Efektivi i Brigadës së 32-të Sulmuese me komisar politik Ramiz Alinë mësynë nga nuk pritej kurrësi, nga Kosova, si me porosi a urdhër të Josif Brox Titos. Nga Rrafshi i Dukagjinit e Bjeshkët e Namuna vërshojnë të tjera forca të shumta ushtarake. Raporti i ushtrisë së etur për gjak në krahasim me atë të popullsisë vendase mund të ishte më shumë se 35 me një! Imazhi i pushtimit ishte një realitet i vërtetë. Strategjia ishte studiuar hollë. Sulmohet maja e qëndresës, Vukli,

ku ishte edhe vendndodhja e Prijësit të pamposhtur, Prekë Calit. Lufta mori fund. Prekë Cali me 13 trimat e vet fortifikohet në shpellën e Tartashicës, një zgafellë në krah të djathtë të fshatit Pepushaj.

Në marrshim e sipër të forcave partizane vizatohen konturet e një masakre çnjerëzore, të një katrahure të cilën zor ta gjeshe edhe në mijëra faqet e romanit lapidar “Lufta e Paqja”. Tabllotë e mynxyrës janë të shumta, të zeza si shpirti i atyre që i realizuan. Le të përmendim disa:

Digjet kulla e malësorit të ndershëm Fran Zefi në Nikç, ku gjuhët e flakës përpijnë edhe trupin e luftëtarit Lukë Toma nga Vishnjeva. Edhe kulla e bajraktarit të Vuklit, me të zotin e shtëpisë brenda, Dedë Gjonin, u shkumbua nga flakët. Kolë Gjon Bajraktari merr shumë plagë, por luftë ishte. Djaloshi Fran Zef Uci i nxirren sytë me bajonetë të pushkës. Ashtu të gjallë, pa sy, e mbulojnë me gurë në Buzë Breg. Deri vonë, në vitet 1990, të afërmit e gjakut jo më eshtrat që s’mund t’i sistemonin në varret e fshatit, por as kokën s’mund ta kthenin nga “kriminelin” që kish rënë për Shqipërinë.

Paradokse që tashmë u ka ardhur koha t’i lëmë pas. Xhelatët e kuq bënë hatanë. Nikë Lucë Bajraktarin e Fran Bracajn i masakruan mizorisht. Ua morën jetën pak e nga pak, duke u zgërdhirë e duke u thënë se do çnderojnë tërë femrat malësore, natyrisht pasi të vrasin gjithë meshkujt e asaj zone “tradhëtarësh” e “banditësh”, gjë të cilën fatmirësisht s’e arritën.

Në emër të besës së shenjtë, Lucë Gjon Bajraktari me Lucë Gjonapukën, i dorëzohen komisarit Zoi Themeli. Po a ka besë i pabesi? Xhelati kriminel i urdhëron viktimat që s’ishin viktimat të çelimit varret e veta. Aty, i propozë të gjallë!...

Nga lartësia e mbi 60 metrave, pikërisht nga shkëmbi i Shën Neriut, hedhin të gjallë për “gallatë” Rrok Zefin. Në Bregun e Kukullit një varrezë e përbashkët përpin në honin e saj trupat e pafaj të dy djelmohave të rinj, Ujk Nikës e Fran Alisë. Broja përjeton gjëmën e masakrimit të Gjergj Qoses e shumë moshatarëve të rinj të tij. Të tërë në një varr hon, pasi u kanë prerë veshët, hundët, duart e këmbët...! Kriminelit të kuq Abaz Fejza, i cili merret porosi direkte nga Ramiz Alia, iu dorëzuan në besë tre djemtë e Mar Bikut. Edhe ata gjetën një vdekje të përçudshme. Para popullit të Mbishkodrës, të grumbulluar me dhunë, pushkatohej pa gjyq prijësit selcianë Gjekë Selca e Gjergj Lulë Toma, të dorëzuar edhe ata në besë tek Mehmet Shehu.

Këto batërdi e qindra të tjera sekuenca të tmerrshme, janë “frytet” e Ramiz Alisë e Mehmet Shehut, të cilat për fatin tonë të keq, historia ende nuk i ka vlerësuar. Megjithatë, populli i ka futur në këngë prej kohësh.

“STOLITË” TUAJA E PËRÇMOJNË FLAMURIN SHQIPTAR...

Në këngët e toponomastikën e Veriut, është i pranishëm kurdoherë prijësi Prekë Cali. Pas mijëra e mijëra vitesh, Shpella e Tartashicës ka marrë emrin e tij. Dhe ja përse: Më 7 shkurt 1945 nga zgafella e saj ngujohet ky përbindësh i Enver Hoxhës së bashku me 13 besnikë të tij. Rrethimi nën komandën e kriminelit të Zoi Themeli është vrastar.

700 forca të zgjedhura nga Enver Hoxha për të kapur në shpellë Viganin e maleve shqiptare me 13 trima janë fare pak. Atëherë Ramiz Alia tregohet dinak. Vihet në veprim mekanizmi i marrjes së kështjellës nga brenda. Padër David Pici beson se pas dorëzimit me kusht, pasi Prekë Cali është një figurë e njohur në Europë, qindra herë më tepër se Enver Hoxha, jeta e Heroit nuk do të vihej në rrezik.

Dhe nuk vonoi shumë. “Sihariqi” erdhi në hyrje të shpellës:

Prekë Cali dorëzohet vetëm me përmbushjen e tre kërkesave.

1-Nuk pranoj të çnderohemi nga kërkush!

2- Marr në mbrojtje e përgjigjem për djemtë e Malësisë dhe për qëllimin tonë final dua komunikim me miqtë e mi perëndimorë!

3- Nuk dua të më falni ju të pabesë, pasi ju njoh me rracë e me koc, por kërkoj të jap llogari para drejtësisë së popullit tim, pasi unë e trimat e mi jemi atdhetarë e ju pushtues!

Të tria kushtet i pranoni me kënaqësi Zoi Themeli, zezani i atij operacioni famëkeq. Gjithsesi, Prekë Cali e ndjente tradhëtinë, ndaj teksa dilte nga shpella u thotë shokëve: “Ky dorëzim ka lidhje me shpëtimin e jetës së ndonjërit nga ju të rinjve, se mua këta zagarë që i njoh mirë, edhe 100 jetë t’i kem, m’i marrin”.

Në ato çaste i ka hedhur dorën në sup të riut Prelë Toma (Smajlaj) e i ka lënë një amanet:

“Jetoni ju, por pashë besën ma merrni hakun!” E trimi Prelë Toma ia ka marrë vërtet hakun komandantit të vet. Në burgun ogurzi të Shkodrës, ku torturohej si mos më keq, gjën momentin, falë fantazisë, mençurisë e trimërisë dhe në bashkëpunim me një të burgosur tjetër, Pal Zefin e Dukagjinit, vret me dorën e vet rreshterin e birucave. Në atë moment, pa u bërë bujë, shpërthen burgun e Shkodrës, nisjet për Malësi, merr tërë familjen me vete dhe nisjet për mërgim.

Jeta e përtej kufirit është një odise tjetër më vete, por le të kthehemi tek tema. Të nesërmen e dorëzimit, Prekë Cali me besnikët e tij ndeshen ballë për ballë me Mehmet Shehun në Rapshë të Hotit.

-T’u thafshin krahët, o burrë i madh i Shqipërisë! U re me shqelm të mirave që të ofruam ne. Nuk e ndoqe udhën tonë. Enveri të pat menduar për ministër. Harram të qoftë, - u fillua në bisedë Mehmet Shehu.

Përgjigja ishte e rreptë. Ortek i vërtetë.

“Faji rëndon mbi ju Madhëri. Ju, Enveri e ata lakejt e vegjël që ju vijnë si zagarë pas, hëngrët në një sahan me rusët e serbët. Ajo çorbë e fëlliqur ju mban sot në këmbë, por jo gjatë ama. Ju edhe Flamurin e Kreshnikëve na e përdhunuat. “Stolitë” ruse e përçudnujnë atë... E paçi gurë mbi shpinë mallkimin e nënave e vajzave shqiptare...! Mos gjetshi prehje as në skëterrën e varrit, o muta...!” Pas këtij fytyfyti të egër deri në tmerr, Mehmet Shehu veçon nga grupi i trimave të Prekë Calit dy vetë: Prelë Tomën (Smajlaj) dhe Maç Lucën, pikërisht dy dëshmitarët okularë të asaj batërdie, të cilët kanë jetuar deri para dy-tre vitesh e i kam njohur fort mirë. Prela ka jetuar në Ulqin të Jugosllavisë e Maçi në Vukël, afër shtëpisë ku kam lindur e jam rritur unë. E ceka këtë element për të thënë së jam qind për qind i saktë me këtë shkrim. E kam mësuar

përmëndësh këtë histori rrëqethëse që kur isha 5-6 vjeç nga Maçi e deshmatar të tjerë okularë.

E përse i veçoi Mehmet Shehu trimin Prelë Toma e djaloshin Maç Luca? Prela, si antiserb, dosjet i kishte edhe në Beograd, Maçi ishte i ri e mund të bënte ndonjë gabim gjatë pyetjeve. Pritej pushkatimi i tyre, pasi një djall e di se si dosjet e Prelë Tomës kishin rënë në dorë të Mehmet Shehut, por të mos harrohet, Ramiz Alia nga andej vinte pak ditë më parë...! Pra, aty në Rapshë, Prelë Toma e Maç Luca u nënshtrohen torturave kafshërore, por për çudi jeta u falet. Odiseja është tepër e gjatë, dramaticiteti i saj i kalon përmasat Shekspiriane...

Prek Cali në Gjyq

Prangat ia mbërthyen duart e fuqishme vetëm në portën e burgut të Shkodrës Tribunit të Maleve Shqiptare. Këtë fat patën edhe 12 besnikët e tij të dorëzuar, siç thamë, në besë Ramiz Alisë e Zoi Themelit, pasi Dedë Gjon Dedën e pushkatoi me dorën e vet rrugës kryekrimineli Mehmet Shehu për antiserb!

Për qëllime të errëta edhe sot e kësaj dite, Prekë Calin e veçojnë në një qeli të posaçme në burg. Fundi i komedisë së inskenuar nga Enver Hoxha “shkruehet” pas dy javësh. Tribuni shqiptar hedh vështrimin e shqiponjtë mbi trupin gjykues.

- Ç’do të thuash për të fundit here o “kryeneç”, - e nguci kryetari.

- Dua takim me të parin tuaj, Enverin, se ai më njeh fort mirë. Kemi edhe një besë nga Mehmeti e Ramizi, të cilët kanë bërë krime mbi njerëz të pafaj. Por Enverit thuajini se Prekë Cali don bisedë me ty. Kaq kam, - tha autoritar. Ajo kërkesë ngeli veç një mirazh ëndrre. Lideri i asaj seance vërtet komunikoi me Enver Hoxhën, po ku ta dinte ai se Prekë Cali ishte përbindësh për përbindëshin Enver. E përbindëshi nuk e fal kurrë kundërshtarin e vet. Prekë Cali u pushkatua me shumë atdhetarë të tjerë që bënë aq tepër për Shqipërinë. Ditën e pushkatimit u dhunua edhe kufoma. Aty në zall të Kirit, skuadra e pushkatimit i pret kokën Prekë Calit të vdekur. Ajo kokë që kish punuar gjithmonë për Shqipërinë, u përdor si top, ku duke i rënë me këmbë, këndonin labçe

“Lule Sefo, lule djalë”.

Sido që ngjau, le të gjykojnë njerëzit e ndershëm kudo që janë nëpër botë, kë la pa varr satanai Enver, Prekë Calin apo veten e vet?

KAPITENI LUKET MARASHI VAZHDON REZISTENCËN

Prijësi i Shkrelit, luftëtari i dëgjuar kapiten Luket Marash Grishaj kishte bërë kërdrinë prej kohësh në luftë kundër turkut e serbit. Ai ishte ushtarak i shkolluar në Perëndim dhe strategjia e tij ishte vdekjeprurëse për ata që vinte në rreth. Ku piketonte mbi

hartë ai, s’mund ta zateste këmbën armiku. Trimat e tij Gjon Martin Lula, Nikë Gjelosh Gjoka, Mirot Paloka, Kolë Lleshi, Prekë Lekë Gjoni, Rrok Nikollë Zefi, Dom Nikollë Gazulli, Pal Thani etj., të cilët kishin luftuar, s’do e ndërprisnin luftën as pas pushkatimit të Prekë Calit. Luket Marashi i rezistonte Enver Hoxhës. Jetën ia kish kushtuar Shqipërisë, për të do vdiste. Tashmë djemtë i kishte të rritur, Dedën, Lleshin e Palokën dhe e dinte se ata do ia marrin hakun. I kish takuar disa herë trimit Luket Marashi që kur nisej për luftë t’i linte amanetin të shoqes:

“Pra në kje se Mali i Zi / Vjen e bjen në Shqipni / deri sa t’jenë djemtë kërthi / Pash njat Zot që na ka falë / Ma dëgjo, grue nji fjalë / Bane zemren gur e krep / M’jau pre kryet djemve në djep / Mos m’jau lsho armiqve n’dorë gjallë / se s’dua t’la n’Shqipni un pralla”.

Por për fatin e mirë të tij e të Shqipërisë djemtë i ishin rritur, ishin bërë trima e kishin shkruar edhe histori. Luket Marashi qëndroi atje në malet e Shkrelit. Edhe i plagosur nuk prante të dorëzohej, por as të kalonte për matanë kufi rit. Nëntë plagë, si Gjergj Elez Alia kishte në trup, tri vetëm në kraharor. Rapsodia e lashtë këtu është konkrete. Vërtet nuk ishte prezente motra që t’i mjekonte plagët, por gurrat e bjeshkëve, bari që sapo kish nisë të gjallojë, zogjtë e malit, gurët e pyjet ishin motrat, vëllezërit, nëna. Këtu s’kemi të bëjmë me nëntë vjet si në ciklin e kreshnikëve, por me disa ditë. Kur vdiq në mal për të mos rënë i gjallë në duart e komunistëve, nuk mallkoi si Gjergj Elezi Alia: “O ju kulla mbetshi shkretë”, por uroi “Shqipëria u çliroftë sa më shpejt nga komunistët!”

E rapsodi popullor e përjetësoi në vargje: “Luket Marashi po viket / Bini, u thotë ai djemve t’vet / N’Qafë t’Grishajve u ba nami / Luftojnë Prela edhe Frani...”

ENVER HOXHA VAZHDON NJË SKENAR TË RI

Edhe pas likuidimit fizik të Prek Calit, skenari kundër kundërshtarëve politikë ishte tepër i zymtë, si skenar mesjetar. Në qendër të shënjestrës u vunë bashkëluftëtarët e Prekë Calit e të Luket Marashit. Luketës i burgosën vëllanë Franin, tre djemtë Dedën, Lleshin e Palokën, si dhe djalin e vëllait, Prelë Franin.

Qelitë e burgut të Shkodrës më 1945 nën urdhërat e drejtorit Hajrullah Vukashi, të toger Babës e të Gjon Kokrrit përjetuan zhdukje monstruoze të shumë patriotëve shqiptarë. Bashkëpunëtor i Prekë Calit ishte edhe djaloshi 25 vjeçar Fran Zefi nga Nikçi, i cili u var në një fillim pranvere në shtyllën mes oborrit të kampit të Bedenit të Kavajës nga dora e drejto-

rit të burgut Haxhi Pela. Ajo shtyllë ogurzezë ka marrë shumë jetë të pafajshme të burgosurish të ndërgjegjes. Edhe kapterri me emrin e pseudonimin Sheramet varte e çonte për në atë jetë kë t’i mbushej mendja. Edhe pas viteve ’50 ashtu vazhdoi.

Njëri nga dëshmitarët e këtyre ngjarjeve thotë se me sa di, Haxhi Pela ende jeton, madje në liri, veçse ka ndërruar emrin. Ajo shtyllë e mallkuar ka marrë edhe jetët e Mark Gjeloshit nga Broja e Dedë Gjeloshit nga Vukli.

Haxhiu e Sherameti, vetëm në muajt shtator-tetor 1948 kanë likuiduar fizikisht plot 72 të dënuar të ndërgjegjes, shumica e tyre jo larg lirim. Po sa mijëra e mijëra të tjerë kanë zhdukur ata e kriminelë të tjerë gjatë 50 viteve? As Luciferri nuk mund të jetë aq katil.

Më vonë Haxhi Pelën e kanë transferuar me urdhër nga qendra në burgun e Osman Pojanit në Maliq të Korçës. Atje ai përdori metoda edhe më çnjerëzore. Dedë Luket Grishaj, Kolë Mhilli, Llesh Luket Grishaj, Maç Luca e shumë atdhetarë të tjerë, të cilëve autori i këtyre radhëve ka fatin e mirë t’u ketë marrë material të bollshëm faktik, kujtojnë barbaritë çnjerëzore, kur Haxhi Pela i fuste të burgosurit politik në baltën e kënetës së Maliqit deri në fyt, u thoshte thërrisni “Rroftë Enver Hoxha”, e kur nuk pranoni, u hipte me shqelma sipër kokës e i fundoste në llucë. Aty i linte përgjithmonë.

Janë këto vetëm një pamje tepër e vockël e këtij skenari të mallkuar që brezat e ardhshëm do ta mbajnë si model të krimeve njerëzore.

Prek Cali dekorohet

Dekoratën e Lartë të Klasit të Parë me Nr. Dekreti 569 të Kabinetit Presidential, të afërmve të Tribunit të Maleve, Prekë Calit, i erdhi dita e bekuar e ia dorëzoi ish-Presidenti i Shqiptarëve, zoti Sali Berisha dhe Ambasadori i SHBA-së, Rayerson. Ishte ky një vlerësim i tërë atyre meritave të mohuara për një gjysmë shekulli nga diktatura.

Sot, zalli i Kirit, bashkë me eshtrat e shumë martirëve të tjerë, ka në gjirin e vet edhe ato të Prekë Calit, kërkimi i të cilave u ndërpre vite më parë për arsye financiare. Është pra ky Zalli i Kirit që në ftohtësinë e brendësisë së vet, ka aq shumë eshtra martirësh, sa edhe gurë. Falë dëshirës së mirë e motiveve njerëzore që krakterizojnë shqiptarët, pasi ne e dimë, gjithçka e kemi për vete, por jetën e nderin për kombin, heronjtë e rënë do futen me dinjitetin që meritojnë në analet e historisë sonë brilante, siç edhe duhet të zënë vend kriminelët në volumet prej turpi.

Prek Cali është nderi i shumë shqiptarëve në botë. Ka ngelur proverbial urimi që nënat e Veriut bashkë me gjirin e mëkimit, fëmijëve të vet u thonë duke përkundur djepin: “M’u rritsh e m’u bëfsh sa Prek Cali”.

ALEATI I KËNDSHËM, KEQAS MË GRABIT

Nga: Aleksandër Çipa

“Hajduti i këndshëm keqas më grabit/ i bëhem shok në vend që ta padis”. Ky është një distik i shumëpërmendur nga krijimtaria e Shekspir. Por vlen për të karakterizuar raportet e bashkëjetesës në të njëjtën qeverisje të një LSI-sti të korruptuar dhe një socialisti të penguar për ta bërë këtë gjë. Në këtë qeverisje po spikat si në një marrëdhënie komike liria dhe privimi për të bërë korruption mes dy anëtarëve të së njëjtës qeverisje.

Ky standard i dyfishtë po e bren shumë më shpejt nga sa mendohej qeverisjen e të majtëve informalë Rama-Meta. Përcaktimi “informalë”, ka të bëjë jo me sjelljen dhe rrethanat e informalitetit si dukuri dhe fenomen social e juridik, por si përkatësi dhe formim individual ideologjik i të dy udhëheqësve. Sepse majtizmi i tyre i ka të plota shenjat dhe brendinë munguese, sikundër edhe papërkatësinë e ndërgjegjshme të tyre.

Mediat këtyre ditëve, po analizojnë e hamendësojnë intrigueshëm për një krizë të brendshme në raportet Rama-Meta. Këto hamendësime i përgënjeshtroi formalisht Petrit Vasili i LSI-së, por Ilir Meta është politikani që e mbron bashkëjetesën në Tiranë dhe e bën me dije tradhtinë apo braktisjen e saj, përmes Gjirit të Lalëzit apo ndonjë mjedisi tjetër rezidencial. Në të vërtetë, në asnjë rast ai nuk e pranon dhe nuk e merr përsipër autorësinë apo aq më tepër protagonizmin e ndarjes politike. I përmbahet suksesshëm skenarit të delegimit të përgjegjësive dhe fajit për ndarjet, ortakut apo bashkëqeverisësit të përkohshëm të tij. Përpiqet që me çdo kusht në publik të mos rezultojë kurrë protagonizmi i tij si arsye për ndarje apo mbyllje partneriteti dhe po aq makiavelisht punon për të rindërtuar skenarin e një partneriteti tjetër perspektiv për të qenë rishtazi në qeverisje. Gjatë kohës që bëhet pjesë e një partneriteti të ri, nuk humbet asnjë çast të shtojë trafikun e influencës, si dhe të shumështojë numerikisht anëtarësinë e partisë së vet dhe të përfshijë në administratë individë që e dinë fort mirë se si fitohet apo se si rekrutohet partiakisht dhe politikisht duke qenë në administratë.

Momentalisht nuk ka tingëlluar çasti as i mbramë e as i mbrapshtë për çarje në qeverisjen dykrerëshe të

së majtës së vendit. Por edhe pse rezultati i zgjedhjeve vendore të 21 qershorit është historik dhe me ngritje të frikshme të LSI-së, sërish brenda së majtës dhe mes udhëheqësisë dykrerëshe të saj nuk ka as optimizëm dhe as harmoni të shpallur fituesish. Heshtja ka nisur më së shumti kur në tri prej bashkive të pretenduara

menti është vetëm një skenë ku koha e pakursyer e të folurit dhe të dalit të ish-kryeministrit Sali Berisha e bën edhe më të rëndë perceptimin për një statusquo alla tranzicion të vendit. Në këtë model të ndenjtur parlamentar, po mbytet nevoja dhe pafuqia për lëvizje dhe ndryshim apo për reforma të cilat do t'i nevojiteshin sa më parë,

ashtuquajturës shoqëri civile, por që në fakt, mund të jenë thjesht një grusht njerëzish të rishpërndarë për qëllime dhe interesa parapolitike. Të gjitha këto, janë elemente që po rristrukturojnë sipas arkitekturës së vjetër të përdorimit partiak dhe prej udhëheqësisë së vjetër politike instrumente dhe aktorë të zellshëm për përdorim të



për fitore të së majtës (përkatësisht në Vorë, Lezhë, Pogradec), por prej kandidatëve LSI-stë u ngulën diplomatë të huaj dhe vëzhgues të shumtë dhe sidomos më të rëndësishmit (të SHBA, BE, OSBE etj), dhe rezultati ishte humbës.

Te kjo e majtë në qeverisje, po mungon fryma e optimizmit dhe energjia për suksese dhe ndryshime cilësore. Te kjo e majtë ekziston droja dhe shmangia për ndryshime të duhura në qeverisje. Arsyet pse mund t'i ndryshojnë ministrat e kabinetit “Rama” mes PS-së dhe LSI-së janë kryekëput të ndryshme, por ende të pakonfirmuara. Ato janë arsye që ndoshta më shumë i ndajnë sesa i mbajnë në hullinë e të qenët ende për kohë të gjatë në qeverisje harmonike. Rezultatet e qeverisjes dhe vlerësimet për të, nuk kanë avokatinë e brendshme të së majtës. Në foltoret e PS-së dhe të LSI-së mungojnë së dali zëdhënës apo edhe përfaqësues të lartë partiakë për të bërë me dije realizime dhe sfida të tejkaluara. Ashtu sikundër diplomacia e së majtës është me diferenca të pashpallura dhe aleatë të ndryshëm në raportet me amerikanët sikundër edhe me atë të BE-së mes dy krerëve të kësaj shumice qeverisëse. Parla-

jo vetëm Shqipërisë së sotme, por çdo vendi tjetër që nuk mund të krahasohet me këtë vend.

Natyrisht, skenari për Parlamentin me solist të vetëm zotin Berisha, mund të ketë interes dhe leverdi për Edi Ramën apo Ilir Metën, por është një torturë psikologjike për krejt shoqërinë shqiptare. Në këtë skenar po triumfon ideja se kapaciteti i vetëm për opozitarizëm ka lidhje dhe po rezulton të jetë ish-qeverisësi në shumicën e kohës së tranzicionit, demiurgu i tij, zoti Berisha. Nga ky absurd, sipas të gjitha shenjave dhe gjasave, kasta jonë politike nuk ka ndërmend të ikë. I nevojitet, prandaj nuk po e refuzon dhe tejkalon atë. Por përmes këtij absurdi, po lihet në fuqi edhe evitimi dhe pengmbajtja e nevojës tjetër për reformë politike në vend, pra reformimi i opozitës që informalisht quhet e djathtë. Po keqtrajtohet kjo reformë si proces që ka lidhje me rivendosjen në poste partiake të kandidatëve humbës të PD-së për kryebashkiakë të vendit. Po krijohet paralelisht një strukturë dhe infrastrukturë diabolike opozitarizmi që përfshin që nga disa dhjetëra web-e opozitare që lidhen me kryeopozitarin e plakur dhe me aktin promovues të një rrjeti organizatash të së

shoqërisë. Në këtë tentativë dhe qëllim, po fshihet thelbi tjetër ndjellakeq dhe gjëmëbërës i kësaj shoqërie dhe këtij vendi, prej udhëheqësisë që nuk heq dorë nga monopoli i rotacionit dhe qeverisjes.

Por si do të vejë fati i kësaj së shumice heterogjene majtiste? A është problem i rianalizimit të brendisë së qeverisjes, analiza për qeverisjen e deritanishme dhe raportet e përfaqësimit PS-LSI në administratë dhe qeveri? Do mbeten shokë në “vend që të padisin”? Kjo dilemë do të jetë subjekti kompleks i zhvillimeve dhe raporteve konkrete mes Ilir Metës dhe Edi Ramës në vitin e tretë të qeverisjes së tyre. Ajo që po thuhet e hamendësohet këto ditë, është një parathënie dhe kapitull i ri në bashkëqeverisjen e tyre. Nuk është një çështje numrash dhe as trafikimesh në sezonin e ri parlamentar, por një kohë e re për rishqyrtim të skenarit dhe pashmangshmërisht mbërritje në gjendjen e ngërçit ku një qeveri përballë me tërmetin e përplasjes së dy ndërgjegjeve politike dhe shtetbërëse. Cila do t'ia dalë? Këtë nuk e zgjidh kursesi revolucionari demokratik” i at-gjyshit politik të tranzicionit, por lindja e një projekti të ri dhe mbërritja e një fryme të re që na mungon.

Pamjet e Elbasanit: Shkruajnë Andi Bushati dhe Mustafa Nano: Policët 'viktima' dhe shteti i kapur nga kriminelët

Analistët e njohur Mustafa Nano dhe Andi Bushati kanë komentuar pamjet e transmetuara në "Opinion" për ngjarjen e Elbasanit. Emëruesi i përbashkët i tyre është: Policia është e trembur për të goditur bandat që mbrohen nga pushteti. "Policët duhen shfajësuar"- thotë Bushati- "sepse gjurmët e krimit të çojnë tjetërkund". Ndërsa Nano është më i ashpër, ai i bën thirrje drejtpërdrejtë Edi Ramës, Kryeministrit të vendit që të faktojë se "bashkëjetesa me krimin e qeverisë së tij ka qenë një aksident".

Në portalin Lapsi.al Bushati shkruan:

"Pamjet rrëqethëse që u trasmetuan të hënën në mbrëmje në emisionin "Opinion", ku 12 policë të drejtuar

tin e trafikantëve të drogës, ashtu si në rastin e dhjetra krimeve ordinere, mendja të shkon te keqbërësit e provincës që fitojnë aq para sa të paguajnë punonjësit e rendit, për të siguruar paprekshmërinë e tyre. Por, kqyrja disa herë e atyre pamjeve, fakti se policëve u ishte përdhosur shefi i tyre, se kjo kishte ndodhur në mënyrë të bujshme dhe në syte e mbi dhjetë dëshmitarëve, të bëjnë të ngresh edhe një hipotezë tjetër.

Po të kqyrësh me kujdes ato pamje duket sikur hyn në botën e brendshme dhe në mendimet më të thella të atyre njerzve të ligjit që në fakt janë "viktima" të një paligjshmërie më të madhe. Ne mund t'i kërkojmë atyre të bëjnë trimin e çartur, mund të presim nga ata të luajnë skena filmash si ato të Korado Katanit, me të cilat jemi mëkuar në

tronike që rrëshqiste ngadalë, duke ngushtuar progresivisht hapësirën e hyrjes, dhe policët që mbetën si të ngrirë para vijës së pragut. Kishin mbi njëzet sekonda në dispozicion, por as që u lipseshin këto sekonda. Edhe sikur portës t'i duheshin disa orë për t'u mbyllur, ata policë do mbeteshin në anën tjetër të kufirit. Sepse vija e pragut të portës ishte tamam si një kufi.

Përtej, ishte një botë përbindëshash, të cilët askush nuk i kish parë me sy, por që të gjithë e dinin se janë përbindëshja. Kjo përshtypje të krijohej. Ndryshe, do ta kishim marrë vesh tanimë se çfarë ndodhi.

Dikush mund të ketë provuar anti-pati për ata policë. Unë nuk e di pse provova keqardhje e empati. Nuk m'u dukën ngordhalaqë. M'u dukën të pambrojtur. Dhe më erdhi mirë që nuk

mëkatet e qeverisë "Rama 1". Tani, që LSI-ja ka qenë një parti e drejtuar, për këtë nuk ka asnjë diskutim. Dhe që ajo nuk është më në pushtet, është një lajm i mirë. Por mandati i qeverisjes në periudhën 2013-2017 nuk dështoi për shkak të LSI-së. Që kanabisi mori rrugët (edhe mbi asfalt doli), që bandat e të fortëve pushtuan territorin, e që ato vinin vërdallë me eskorta, pa pyetur për policinë, kjo është një veprim ekskluziv e PS-së.

Që puna ka arritur deri aty sa 12 policë të zbythen para një makine, e shteti të mos guxojë të sqarojë se çfarë ndodhi, kjo është veprim absolutisht e PS-së. Madje, vepra më e shëmtuar në gjithë trashëgiminë e PS-së në pushtet pas vitit 1990. Por e keqja nuk është këtu. E keqja është se Rama po kërkon të vendosë rendin publik, e të rimarrë



nga numri dy i drejtorisë rajonale të Elbasanit qëndrojnë si hunj, të frikësuar, të shushatur dhe të tredhur për t'u vënë në ndjekje të atij që i kishte sulmuar, nuk është vetëm një akuzë për uniformat blu. Pse, ashtu sikurse duket edhe në pamjet filmike ata nuk përfitojnë nga dera që ndenji për disa kohë e hapur, por qëndrojnë hezitues dhe të dërrmuar përpara saj? Pse, në fund të fundit, ata nuk guxojnë as t'a përmendin në komunikata dhe në komunikimin publik emrin e të dyshuarit të cilin opozita e ka treguar me gisht duke thënë se është Suel Çela?

I gjithë ky enumeracion pyetjesh diskredituese të bën të mendosh për një implikim të policisë lokale me bandat e qytetit. Ashtu si në ras-

fëmijëri, por ne nuk mund të harojmë për asnjë çast, se nuk mund të ketë kurorë heronj për sa kohë ata tradhëtohen nga lart, nga eprorët, politika, qeveria. Ndoshta impotencia e tyre buron pikërisht nga kjo gjë. Nga fakti se ata dinë më shumë se ne që u kërkojmë të luajnë heroin. Ata e kuptojnë të parët se ka dyer që u janë mbyllur nga lart. Ata e ndjejnë se nuk kanë më shumë kompetenca, se ato të aktorëve të neveritshëm të videove amatore. Dhe për këtë duhen shfajësuar. Gjurmët e krimit të çojnë tjetërkund

Mustafa Nano në gazetën Mapo shkruan:

E dini se çfarë nuk më shqitet nga mendja prej pamjeve filmike të ngjarjes së Elbasanit? Ajo porta elek-

guxuan më tepër. Më erdhi mirë sidomos pak më pas, kur u mor vesh se policia, prokuroria e struktura të tjera të shtetit, nuk morën guximin as të hedhin sadopak dritë mbi atë ngjarje.

Ja, në këtë pikë kemi arritur. Edi Rama e Co. duhet ta kishin ditur se bashkëpunimi me krimin nuk të lejon më të kthehesh prapa. Duhej ta kishin ditur edhe nga shembulli i Sali Berishës, që e udhëhoqi Shqipërinë në një joint venture me krimin për më shumë se dy dekada. Veçse – duhet bërë ky saktësim i rëndësishëm – duke i mbajtur nën kontroll kriminelët.

Do të vazhdojë ky avaz? Nuk kemi si ta dimë. Mandati i dytë i Ramës sapo ka nisur. LSI-ja iku nga koalicioni duke marrë me vete edhe të gjitha

nën kontroll territorin, me të njëjtët policë që pati katër vitet e shkuara. Kjo është e pamundur. Ajo polici ka qenë haptazi e lidhur me krimin. Zinxhiri i komandës në policinë e Republikës duhet zhbërë i tëri.

Unë nuk e di nëse kjo mazhorancë ka fuqi për ta fituar betejën me krimin. Nuk e di nëse Edi Rama është në gjendje të na provojë se bashkëjetesa me krimin e qeverisë së tij ka qenë një aksident, apo një ekspedient, që duhet arkivuar. Janë vetë këta të fundit që duhet të na bindin. Dhe mund të na bindin jo pas katër vjetësh, por tani, menjëherë. Me veprime konkrete.

Votes were bought with drug money, the parliament is filled with criminals

The government is created, but the public opinion and international's attention is focused on the violation of free votes. The final report of OSBE/ODHIR about the elections in June 25th in Albania is scandalous, with harsh criticism.

The report also points the problem of selling and buying votes in our country.

According to OSBE, buying votes is the biggest problem of these elections, and they demand that this phenomenon to be solved through legal mechanisms.

The report states: "During the election day, there are noticed irregularities and procedural neglects". "There were noticed groups voting and interventions from the party activists". The

law for the counting groups should be changed, they should not be political!

One of the main recommendations of OSBE is the creation of a new comprehensive electoral reform. "The depoliticization of the public administration should be deepen." is also mentioned in the OSBE report.

All Albanians know that Saimir Tahiri, back in time, minister of justice, used drug money to buy the votes.

Likewise, the mayor of Durres, Vangjel Dako or Elbasan's Qazim Sejдини, accused many times for their connections with the criminal groups of drugs and trafficking of guns and human beings, were also active in buying votes and manipulating the election's result.

The ambassadors Donald Lu and Romana Vllahutin are expressed for



the two deputies of the Socialist Party in the district of Lezha, Arben Ndoka and Arben Çuko, accusing them directly as problematic persons, but Edi Rama organized the state structures to violate the voters. He bought votes in the poorest classes of the society and exerted pressure at the polling stations, where even had gunshots in Lezha, injuring one of the LSI activists in Shengjin, Florian Dushku, an injury that forced the President of Republic, Ilir Meta to visit the scene, whose statements were extreme and scary:

"We can invite the people to take guns against Edi Rama's criminals in defense of the free votes of the violated people"

When such expressions are articu-

lated by a state leader, or the Constitutional Guarantor, as our law recognizes, the situation is very bad in our country.

So the arrival in power of this government is neither less nor more, but the installation of a dictatorship and the bloom of the organized state crime, as the persons with criminal precedents are now MPs of the Parliament of Albania.

This crime scheme installed in Parliament will be an obstacle to the justice reform and the integration of Albania into the Euro-Atlantic structures, making Albanians' lives ever more insecure and creating space for the rulers to abuse the power of crime and corruption.

Ermira Therqaj

The masks attack the minor daughter of the police officer

Yesterday, around 13:00 in Perash, Shkodra, near the middle school "Martin Camaj", three masked men got out of their car and attacked an 8th grade kid in this school, trying to whip the child. In those moments, in that exact place, luckily, hundreds of parents were waiting to meet their children after the end of the lesson. They have physically got in touch with the criminals and have managed to save the minor, M. Dushi. The masks, after failing, have quickly ran away shouting: "Tell your father that we will not forgive him, whoever harasses us, we bury deep into the earth." So, the eye-

witnesses who knew this child stated that the minor's father is an effective of the State Police in the district of Shkodra for many years. After researching, we learned that the child of the police officer Admir Dushi was attacked yesterday. This cop has been threatened by some people since he has participated in many actions for the destruction of Cannabis sativa, especially in the deep mountainous areas of Dukagjin. In fact, in the last 26 years more than 200 police officers have been killed. The gangs are powerful and have filled the whole territory of the country with Cannabis



sativa. They have even fired at the police helicopter in Dukagjin during an

action for the destruction of Cannabis sativa.

The Editorial Office

Maqedoni: Kriza politike shkaktoi rënie më të madhe nga ajo që pritej

Në një intervistë për agjencinë Reuters, në suaza të Konferencës së guvernatorëve të bankave qendrore e mbajtur në Sarajevë, guvernatori i Bankës Popullore të Maqedonisë, Dimitar Bogov tha se kriza e zgjatur politike i ka shkakuar dëme serioze ekonomiksë së Maqedonisë dhe është rëndë të pritjet rritje ekonomike brenda këtij viti, pas rënies që ndodhi në gjysmën e parë të vitit.

"Parashikimet tona në prill për rritje ekonomike prej 2.5 për qind duket se ishin tepër optimiste. Kriza politike shkaktoi rënie më të madhe nga ajo që ne parashikonim", tha Bogov.

Ai më tej tha se duke pasur parasysh se në gjysmën e parë të këtij viti PBB e Maqedonisë ka shënuar rënie



prej 0.9 për qind dhe shtoi se "do të lisha i lumtur nëse këtë vit e përfundojmë me rritje pozitive ekonomike".

"Nëse kemi stabilitet të plotë politik dhe politika ekonomike nga Qeveria e re, mund të presim që rritje eko-

nomike të kthehet në dinamikën që kishte para fillimit të krizës politike në vitin 2015", vlerëson Bogov, duke shtuar se pret që Qeveria të vazhdojë me konsolidimin fiskal me qëllim të stabilizimit të deficitit buxhetor që vlerësohet në rreth 3 për qind këtë vit.

Gjatë vlerësimit të tij për normat e kamatës, Begov thotë se nuk sheh nevojë për përshtaje të mëtejshme të normës bazë të kamatës, e cila është në një minimum historik prej 3, 23 për qind, por shton se me vëmëndje do ta ndjekë gjëndjen e sektorit të jashtëm dhe politikat fiskale gjatë viteve të ardhshme.

Telegrafi

The criminal gang maltreating four citizens in the middle of Tirana

Two days ago, around 13:00 on "Ymer Ndrejoni" Street in Tirana, two motorcyclists and motorcycle helmet in the head physically maltreated the member of Fushe-Arres Municipal Council and at the same time elected as a member of Shkodra County Council, Selvator Gjoka. He was driving and traveling from Mother Teresa airport together with his wife Brunilda Doda, her father-in-law Ndue Doda and her mother-in-law Lina Doda. As soon as they got off the car, two people attacked surprisingly. One has pulled out a pistol firearm and the other exercised physical violence over the citizen Selvator Gjoka, warning him that they would kill him next time if he did not silence. The two criminals, according to the other three persons present at the event, have explained that they have only some issues to clear with the person Selvator Gjoka and with the others, they have

nothing. They left leaving Selvator in an unconscious state in the street and they quickly disappeared. The injured person has been sent urgently to the nearest health center, where the doctor Dr. Sinan Manjani has been treated him in the emergency room.

According to the information from our newspaper, Selvator Gjoka, with profession as a dentist, represents the Justice, Integration and Unity Party (PDIU) at the Municipal Council of Fushe-Arres, otherwise known as the Chams Party. It is a small political force unmentioned for corruption and during the electoral campaign for local government 2015, Gjoka was put under the pressure of the two major political parties' SP and DP and terrorist groups. Islamic groups with criminal and economic interests near the two major parties had pressed this guy to not secure the popular vote for the City Council. But he received the

necessary votes, however, consistently denouncing the drug phenomenon, raising concerns that state structures are not destroying cannabis parcels. This denunciation seems to have bothered the drug barons, who in northern Albania have cultivated large, sheltered areas in the last four years.

In fact, this phenomenon of cannabis and corruption has been recently strongly denounced by the US Ambassador, Donald Lu and the Ambassador of the European Union, Romana Vlahutin. Albania has returned to Colombia in Europe. Countries like Italy, Holland, Belgium, Greece, Denmark, etc. have raised concerns about drug-related gangs related to the politics and have also proposed the ban on Albanians in the SHENGEN area. Many police officers have already been arrested, but only after pressure from internationals and media surveys. However, the public prosecution and

courts, also corrupted and drug-related to cartels, have acquitted innocent hundreds of big fishes, as they have just been mentioned by the US Ambassador Lu and have left in prison only some workers who were paid by 10 up to 15 euros a day.

From the first data, the denunciation of the drug by the Fushe-Arres Municipal Council member, also elected as a representative of that community in Shkodra County Council, Selvator Gjoka, was the cause of physical violence against him, of course, to give the last warning for physical elimination. Cases of such killings are many. If someone denounces the drug bands, they are eliminated.

The criminal courage is frightening and bound up with powerful government clans.

The Editorial Office

Shqipëria, me droga të lira e prevalencë të madhe përdorimi

Ligji ekonomik i ofertës dhe kërkesës na dikton se kur në treg rritet oferta, çmimi për mallin (edhe pse i jashtëligjshëm) bie. Nga të dhënat që Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet ka grumbulluar prej vendeve anëtare rezultojnë se Shqipëria ka çmimet më të ulëta në rajon për sa i përket hashashit dhe kokainës, ndërsa ka prevalencën më të lartë të përdoruesve gjatë jetës. Për pjesën më të madhe të ekspertëve kjo vjen për disa arsye në Shqipëri. Së pari, konsiderohemi vend origjine për kanabisin dhe vend transit për kokainën. Pjesa më e madhe e drogës synon që të kalojë në Europë, por një sasi mbetet në vend, duke rritur kështu ofertën dhe duke ulur çmimin. Së dyti, fuqia blerëse në Shqipëri është e ulët dhe përdoruesit nuk kanë mundësi që të blejnë drogë të shtrenjtë. Ky faktor sipas ekspertëve ka sjellë edhe cilësinë shumë të dobët që qarkullon në vend. Krahasuar me rajonin, Shqipëri ka prevalencën më të lartë të përdorimit gjatë jetës të kanabisit dhe të kokainës, veçanërisht për këtë të fundit prevalenca është dhe më e lartë në botë. Sipas të dhënave të UNODC, ku mund të gjenden të dhënat e krahasueshme për të gjithë vendet e rajonit për çdo individ që ka provuar së paku njëherë gjatë jetës kokainë në Serbi ka 25 individë në Shqipëri. Nga të dhënat e krahasueshme

për vendet e rajonit për sa i përket kanabisit, renditemi të dytët pas Kroacisë për përdorimin gjatë jetës. Ndërkohë, çmimet e ulëta rrezikojnë që ta kthejnë Shqipërinë në një destinacion për drogat e lira. Sipas raportit botëror për përdorimin e drogave, çmimet në tregun e zi të substancave ilegale

janë shumë më të ulëta se mesatarja e rajonit, veçanërisht për kokainën. Sipas të dhënave të grumbulluara nga UNODC, çmimi për një gramë kokainë në Shqipëri kushton mesatarisht 80 dollarë, ndërkohë që mesatarja e rajonit përlllogaritet rreth 100 dollarë. Edhe kanabisi kushton më lirë se në

çdo vend tjetër të rajonit, përdoruesit mund të disponojnë një gramë marijuanë për vetëm 5 dollarë, ndërkohë që e njëjta sasi blihet në Malin e Zi për 26 dollarë.

Monitor



Historia e dy miteve: Kush e themeloi Romën e Lashtë?



Ashtu si të gjitha shoqëritë e lashta, romakët zotërojnë një histori themelimi tepër heroike. Ajo që i bëri romakët të ndryshëm, është se ata krijuan dy mite të dallueshme të krijimit për veten e tyre.

Në të parën thuhet se ata e kanë prejardhjen nga refugjati mbretëror trojan Enea, (djali i perëndeshë Venusit).

Ndërsa në të dytën thuhet se qyteti i Romës u themelua nga Romulo, djali i një princeshe tokësore dhe Perëndisë Mars.

Historia e legjendës së parë

Romuli themelon Romën, sipas traditës, duke u bërë mbreti i parë romak. Historia e Romulit, vëllait të tij binjak Remi, dhe themelimi i Romës është një nga legjendat më të njohura në lidhje me qytetin e Përjetshëm, e cila tregon se si Perëndia Mars u bashkua me virgjëreshën Rea Silvia, bijë e një mbreti të rrëzuar.

Nga ky bashkim lindën njëherësh Romuli dhe Remi; dhe mbreti dha urdhër që binjakët të hidhen në lumin Tiber.

Kur shporta me dy foshnjat ngeci në shkurre pranë bregut një ulkonjë i gjeti dhe i ushqeu derisa bariu Faus-

tulus i mori në shtëpinë e tij. Kur u rritën, Romuli dhe Remi mësojnë se ishin bijtë e Marsit dhe Reas, si dhe profecinë se ishin destinuar për të patur qytetin e tyre – këtu lindi rivaliteti; Romuli vret vëllanë dhe qytetit mori emrin e tij, Romë.

Legjenda e dytë

Por rreth krijimit të Romës ka edhe një tjetër legjendë: Në fund të luftës së Trojës qyteti u shkatërrua, burrat u vranë, gratë u bënë skllave, disa trojanë mundën të iknin, mes tyre princ Enea, djali i Perëndeshës Venus dhe

njeriut Anshiu.

Ndërsa Troja po digjej, Enea la qytetin, me të birin, Askan, dhe pasuesit e tyre. Pas shumë aventurash e vështirësish, trojanët mbërrijnë në Laurentum në bregun perëndimor të Italisë, ku Enea martohet me Lavinian, bijën e mbretit të zonës, Latinus, dhe themelon qytetin, të cilin e quajti Lavinium, për nder të gruas së tij.

Ndërsa Askani, bir i Eneas, vendosi të ndërtonte një qytet të ri, e quajti Alba (Longa) dhe malin afër, Alban – pranë do të ndërtohej Roma.

Por kush është themeluesi i Romës – Romuli apo Enea?


Kato, historian, filozof, në fillim të shekullit të dytë pes, pranon idenë e Eratosthenit se midis themelimit të Romës (shek. VIII pes) dhe rënies së Trojës (shek. XII pes) qëndrojnë 400 vjet – 16 breza – dhe ai kombinoi të dy historitë për të dalë me atë që është versioni i pranuar, ku Romuli s'mund të jetë nipi i Eneas, biri i Askanit, por te paktën të duket se është pasardhësi i largët i heroit trojan.

Popull i zgjedhur

Të dyja mitet ndihmuan në themelimin e romakëve si popull i zgjedhur nga Zoti, prejardhja e të cilëve i kishte gjurmët që nga Troja dhe bota helenistike.

Tradita romake tregon se ishte qyteti i lindjes së Romulos, Palatine Hill, në të cilin u shënuar ai që u quajti "Viti 1" (ose viti 753 para Krishtit në kalendarin kristian të perëndimit).

Gërmimet arkeologjike në kodër kanë gjetur pjesë që datojnë të paktën që në vitin 1000 para erës sonë.



Detaje të reja mbi vrasjen, sekuestrohet celulari i gjyqtares

Gazetarja Klodiana Lala në News24 ka rrëfyer detaje të tjera nga ngjarja e rëndë, ku Gjyqtarja e Shkodrës, Fildez Hafizi nëna e dy fëmijëve u vra me një plumb në kokë nga ish-burri i saj. Prokurorët kanë sekuestruar dje celularin e gjyqtares me qëllim për të marrë të gjithë faktet, nëse ka patur apo jo kontakte me ish-bashkëshortin e saj, apo nëse ai e ka kërcënuar së fundmi. Referuar dëshmitëve të personave të pranishëm në vendngjarje, por edhe hetimeve paraprake të policisë, Fadil Kasemi e ka pritur për një kohë shumë të gjatë ish-bashkëshortin e tij ditën e djeshme, e cila ka qëndruar më shumë se një orë në sallonin e bukurisë para të cilit e vrau. Sapo ka dalë nga salloni, gruaja ka parë ish-burrin e saj, dhe duke parandjerë rrezikun, ka nxituar të hipë në makinë. Por Fadil Kasemi i është afruar me shpejtësi. Mësohet se fillimisht ai i ka folur dhe ka tentuar të hipë në makinë, por pasi nuk ka mundur, e ka qëlluar atë me një plumb në kokë, nga xhami i pasagjerit. Pas kësaj, ai ka tentuar të largohet, por është kapur nga forcat e policisë.



KUSH ISHTE FADIL KASEMI, VRAU NË MES TË TIRANËS ISH-GRUAN GJYQTARE, SHKELI LUTJEN E FËMIJËVE: BABI MOS E VRIT MAMIN!

Dy vite më parë në Golem, Fadil Kasemi, ish bashkëshorti i gjyqtares së vvarë sot prej tij, i shpëtoi për mrekulli vrasjes në sy të dy fëmijëve. Policia arriti të shmangë krimin dhe ta prangosë në atë kohë bashkëshortin vrasës.

Në atë kohë magjistratja, kandidatë për gjyqtare tha se çifti ishte divorcuar në maj, por bashkëshorti nuk kishte qenë dakord.

Ajo ishte në plazh në atë kohë me nënën e saj dhe fëmijët.

Kur shkoi te shezlongët me të birin, gjyqtarja, (sot e ekzekutuar) ka parë të afrohet Fadili, dhe i ka thënë atij të mos i linte fëmijët jetimë, pasi ky i fundit kishte tentuar të nxirrte një send nga canta.

Në korrik 2015, ish burri dhe ish bashkëshortja janë përleshur mes tyre. Ka ndërhyrë djali për ti ndarë. Më pas Fidelsi ka vrapuar duke rrëmbyer cantën dhe në vrap e sipër bërtiste: Po më vret, po më vret.

Një pronar hoteli aty ka lajmëruar policinë e cila erdhi menjëherë. Brenda cantës u gjet pistoletë tip TT model

54 me kreher të vendosur në të. Policia e ka gjetur Fadilin të ulur në shezlong duke mbajtur kokën me dorë. Përpindja e alkolit rezultoi 0.1%-0.2 përqind cka në fakt nuk ishte në sasi aq të madhe sa ai të pretendonte se

kishte humbur logjikën nën efektin e alkolit.

Fadil Kasemi në atë kohë u arrestua nga shërbimet e policisë së Kavajës dhe ndaj tij u vendos masa e arrestit në flagrancë. Por sic duket, asnjë ligj

nuk e paska mbajtur dot brenda qelisë vrasësin gjakftohtë që "I kishte bërë benë gruas" për ta ekzekutuar.

Dëshmia e fëmijëve pas ngjarjes në Golem në 2015

Mediat kanë zbardhur në 2015-ën dëshminë e fëmijëve të dhënë për hetuesit, pas ngjarjes së tentativës për vrasjen e Hafizit në plazhin e Golemit.

"Mos e vrit mamin" i lutej djali babait për nënën e tij e cila edhe ajo e rrëzuar në rërë lutej "Mos e lër djalin jetim". Djali shikonte sesi babai i tij, po tentonte të nxirrte pistoletën që e kishte në kthefin e vendosur në brez në tentativën për të kryer një vrasje të mundesh ndaj nënës së tij, e cila ishte e divorcuar. Fatmirësisht ndërhyrja e një pushuesi duke izoluar 51 vjeçarin Fadil Kasemi dhe marrë armën parandaloi krimin e rëndë. E gjitha ndodhi mesditën e 19 korrikut 2015 mes pushuesve që kishin zgjedhur plazhin e Golemit për të kaluar të nxehtin duke shkaktuar panik", thuhet në këtë dëshmi të shkëputur nga mediat.

